



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN
FAKULTETI EKONOMIK

PROGRAMI: FINANCË DHE KONTABILITET I APLIKUAR

RIAKREDITIMI

Niveli: Bachelor (BSc)

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT



Janar 2021, Gjilan

Ky raport vetë-vlerësues është përgatitur nga stafi i Fakulteti Ekonomik, Universiteti Gjilani, bazuar në kërkesën dhe udhëzimet e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AKA).

© 2021 Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Gjilani “KADRI ZEKA”

Adresa: Zija Shemsiu, 60000 Gjilan,

Dekan:

Prof Ass.Dr.Xhevat Sopi

Email: xhevat.sopi@uni-gjilan.net

Tel: Mob: +383 44 19 56 85

Prodekan:

Prof.Ass.Dr. Shefket Jakupi

Bartwsit e programit:

1. Prof.Ass.Dr.Lutfi Zharku
2. Prof.Ass.Dr.Arben Mustafa
3. Ass.Dr.sc.Arben Sahiti

Në asistim të :

1. Prof.Ass.Dr. Refik Kryeziu
2. Ass. Dr.sc.Nexhat Shkodra,
3. Ass. Arbenita Kosumi,PhD (c)
4. MSc. Gëzim Selimi - Bordi Industrial i UKZ
5. Bsc. Monika Sylejmani – alumni

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
LISTA E AKRONIMEVE.....	3
LISTA E TABELAVE.....	4
1 HYRJE.....	5
1.1 Metodologjia e përgatitjes së raportit.....	6
1.2 Një vështrim i shkurtër i institucionit dhe programit në vlerësim.....	6
2 PROGRAMI: Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar.....	18
2.1 Misioni, objektivat dhe administrimi.....	21
2.2 Menaxhimi i cilësisë.....	25
2.3 Stafi akademik.....	31
2.4 Përmbajtja e procesit arsimor.....	39
2.4.1 Pasqyra e lëndëve për programin: Financë dhe Kontabilitet i aplikuar (BSc).....	45
2.5 Studentët.....	48
2.6 Hulumtimi.....	53
2.7 Infrastruktura dhe burimet.....	58
3. EVOLUCIONI DHE ZHVILLIMI I KOHËVE TË FUNDIT I REGJISTRUAR QË NGA VLERËSIMI I MËPARSHËM (nëse ka).....	64
4. SHTOJCAT.....	66

LISTA E AKRONIMEVE

<i>ECTS</i>	Sistemi European i Transferimit të Krediteve
<i>CBA</i>	Projekti “Cilësi dhe Barazi në Arsim”
<i>FEMC</i>	Fondacioni European për Menaxhimin e Cilësisë
<i>ZEAL</i>	Zona Europiane e Arsimit të Lartë
<i>SJC</i>	Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë
<i>KEK</i>	Kuadri European i Kualifikimeve
<i>SUE</i>	Standardet dhe Udhëzimet Europiane
<i>IAL</i>	Institucionet e Arsimit të Lartë
<i>SBC</i>	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë
<i>SSBC</i>	Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
<i>NJBSCFK</i>	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë Fakultetit Ekonomik
<i>ONS</i>	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
<i>TKP</i>	Treguesit Kyç të Performancës
<i>KKKK</i>	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve Kosovë
<i>PBKV</i>	Planifikim, Berje, Kontroll, Veprim
<i>SC</i>	Sigurimi i Cilësisë
<i>KKZEAL</i>	Kuadri i Kualifikimeve për Zonën Europiane të Arsimit të Lartë
<i>FE</i>	Fakulteti Ekonomik
<i>KFE</i>	Këshilli i Fakultetit Ekonomik
<i>SWOT</i>	Pikat e Forta, Dobëta, Mundësitë, Sfidat
<i>UKZ</i>	Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”
<i>MASH</i>	Ministria e Arsimit, Shkencës

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: <i>NJA dhe organizative të UKZ, numrin e programeve që ofrohen dhe gradat përkatëse që fitohen pas përfundimit të studimeve. (UKZ)</i>	9
Tabela 2: <i>Procesi i akreditimit të UKZ dhe programeve studimore 2013-2021</i>	9
Tabela 3: <i>Numri i studentëve të regjistruan në vitet 2013-2020</i>	13
Tabela 4: <i>Numri i studentëve në raport me numrin e stafit të rregullt dhe stafit të angazhuar akademik në vitin 2020</i>	14
Tabela 5: <i>Programi Financë dhe Kontabilitet i aplikuar (BSc)</i>	19
Tabela 6: <i>Analiza SWOT për misionin, objektivat dhe administrimin:</i>	24
Tabela 7: <i>Sistemi i Sigurimit të Cilësisë në UKZ</i>	25
Tabela 8: <i>Analiza SWOT për sigurimin e cilësisë:</i>	30
Tabela 9: <i>Të dhënat në formë tabelare për stafin akademik - Full Time (FT)</i>	31
Tabela 10: <i>Rekapitullimi i stafit akademik - Full Time (FT)</i>	32
Tabela 11: <i>Të dhënat në formë tabelare për stafin akademik - Part Time (PT)</i>	32
Tabela 12: <i>Rekapitullimi i stafit akademik - Part Time (PT)</i>	33
Tabela 13: <i>Pjesmarrja e stafit në trajnime</i>	35
Tabela 14: <i>Analiza SWOT për stafin akademik:</i>	39
Tabela 15: <i>Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit arsimor:</i>	44
Tabela 16: <i>Tabela me informatat për vitin I; semestri I</i>	46
Tabela 17: <i>Tabela me informatat për vitin I; semestri II</i>	46
Tabela 18: <i>Tabela me informatat për vitin II; semestri III</i>	46
Tabela 19: <i>Tabela me informatat për vitin II; semestri IV</i>	47
Tabela 20: <i>Tabela me informatat për vitin III; semestri V</i>	47
Tabela 21: Tabela me informatat për vitin III; semestri VI	48
Tabela 22: <i>Analiza SWOT për studentët:</i>	52
Tabela 23: <i>Analiza SWOT për hulumtim:</i>	57
Tabela 24: <i>Plani financiar 2021-2023</i>	59
Tabela 25: <i>Kategorit e shpenzimeve</i>	59
Tabela 26: <i>Paraqitja e të dhënave për: hapësirat, sallat e mësimi, kabinetet, amfiteatrot sipas numrit dhe sipërfaqës në m² që shfrytëzohen FE</i>	60
Tabela 27: <i>Analiza SWOT për infrastrukturë dhe burime:</i>	63

1 HYRJE

Ky raport vetë-vlerësues (më tutje RVV), është përgatitur nga Fakulteti Ekonomik (më tutje FE) i Universitetit Publik të Gjilanit “KADRI ZEKA” (më tutje UKZ) bazuar në Udhëzuesin e AKA-së për përgatitjen e RVV-ve për njësinë akademike. Qëllimi i përgatitjes së këtij raporti ka të bëjë me përgatitjet për riakreditim të programit Financë dhe Kontabilitet i aplikuar, për periudhën kohore 2021 – 25 për studime bachelor.

Programi i studimit në vlerësim është në harmoni me:

1. Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021;
2. Planin Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021;
3. Planin Strategjik të UKZ 2017-2022;
4. Huluntimi i tregut të punës në Kosovë, rajon dhe në BE:
 - a. Agjencia e Statistikave të Kosovës, [Vjetarët statistikor të cdo viti; Statistikat Afatshkurtra të Industrisë](#);
 - b. [Europian Comision](#), From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs In the Western Balkans,
 - c. [Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arsimi dhe Tregu i Punës në Kosovë dhe Bashkim Evropian](#)
5. [Huluntimi për karrierën e studentëve alumni, 2019](#) ; [Propozimet nga huluntimi me-alumni](#)

Referuar këtyre dokumenteve dhe huluntimeve të tregut të punës në Kosovës, realizuar nga Komision Evropian por edhe takimeve me Bordin Industrial dhe bisedat e thelluara me ta, rezulton se mundësitë më të mëdha për punësimin e të diplomuarve janë në biznes. Evidentohet se një potencial të lartë të punësimit të të diplomuarve e kanë treguar bizneset e vogla dhe të mesme.

Mbi këtë bazë dhe duke mbështetur në një punë të palodhëshme dhe entuziaste të stafit të tij, FE i UKZ paraqet këtë Raport Vetëvlerësimi për akreditimin e programit të studimit Financë dhe Kontabilitet i aplikuar, si një orientim të tij:

- i. për përgatitjen e gjeneratave për tregun e punës, me theks të veçant në sektorin privat por edhe atw publik duke u mbështetur në të arritura bashkëkohore shkencore nga fusha e financës dhe kontabilitet dhe aplikimin e tyre në praktikë;
- ii. përgatitjen e kadrove për të thelluar aftësitë kërkimore shkencore dhe për të avancuar në nivele më të larta të studimit.

Në përmbajtje të këtij raporti janë përfshirë rezultatet e analizave të gjera si në aspektin e kurrikulës ashtu edhe në atë nevojave të tregut dhe të shoqërisë. Prandaj raporti në vazhdim është rezultat i një debati të gjerë dhe analize të gjithanshme në funksion të përgatitjes së një programi të studimit që do të jetë në harmoni me nevojat e tregut të punës.

Raporti është përgatitur me pjesëmarrje të gjerë të stafit akademik të FE, studentëve alumni dhe përfaqësuesve të biznesit.

1.1 Metodologjia e përgatitjes së raportit

Struktura dhe përmbajtja e këtij raporti bazohet në udhëzimet e marra përmes Udhëzuesit të AKA-së për përgatitjen e RVV-ve.

Dekani i Fakultetit, fillimisht ka bërë një hulumtim për karrierën e të diplomuarve të tij (<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2017/06/Rezultatet-e-hulumtimit-me-alumin-shtator-2019.pdf>) dhe gjithashtu ka mbajtur takim konsultative me alumnit (dt.11.10.2019, <https://www.uni-gjilan.net/lajmet/ukz-ka-mbajtur-takimin-e-pare-me-alumni-te-fakultetit-ekonomik/>) ku janë diskutuar rezultatet e hulumtimit. Më pas, është mbajtur takim me përfaqësues të bizneseve përmes Bordit Industrial (dt.20.10.2019, <https://www.uni-gjilan.net/lajmet/drejtues-te-fakulteti-ekonomik-kane-organizuar-takim-me-perfaqesues-te-bizneseve/>), ku ka pasur një diskutim të gjerë për nevojat e industrisë dhe kapacitete me të cilat disponon Fakulteti Ekonomik. Në të dy këto takime ka marrë pjesë shumica e stafit akademik. Për shkak të situatës pandemike, takime të tilla nuk janë realizuar gjatë vitit 2020 por janë marrë për bazë diskutimet dhe propozimet nga një vit më përpara si dhe janë zhvilluar takime individuale me përfaqësues të bizneseve përmes drejtuesve të bordit Industrial

Ndërkohë, në organizim të Dekanatit, është zhvilluar takimi punuese me stafin e Fakultetit Ekonomik (dt. 08.10.2020) dhe ku është diskutuar për orientimin rreth programeve studimore me të cilat Fakulteti Ekonomik do të aplikoj për akreditim dhe janë bërë propozimet për bartësit e programeve dhe orientimet për grupet punuese. Më pas, Këshilli i Fakultetit Ekonomik, në mbledhjen e mbajtur më dt.15.10.2020, ka aprovuar programet me të cilat do të aplikoj për akreditim, bartësit e programeve dhe grupet punuese (<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2017/06/Vendim-i-KF-per-formimin-e-grupeve-punuese-per-akreditim-Financ%20ab-dhe-Kontabilitet-i-Aplikuar.pdf>). Këto programe janë aprovuar edhe nga Senati i UKZ në mbledhjen e XV të tij me dt. 26.10.2020. Pas këtyre procedurave dhe formalizime grupi punues ka vijuar punën në hartimin e RVV-së. Një takim i përbashkët është mbajtur më datë 11.11.2020 ku fillimisht janë caktuar parimet për strukturën e programeve studimore, përkatësisht kurrikulës, pastaj është bërë dakordimi për përmbajtjen e tyre.

Pas punës në grupe të vogla, ku janë ndarë detyra për hartimin e pjesëve të veçanta të RVV është mbajtur edhe takimi i fundit i përbashkët ku është harmonizuar kjo formë e RVV-së. Vlerësimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport për çështje të ndryshme, mbështeten në të dhënat ekzistuese të prezantuara në këtë raport. Po ashtu, në raport është analizuar edhe metodologjia e mësimdhënies, vlerësimi të studentëve, dizajnimin dhe implementimin të ECTS kredive .

1.2 Një vështrim i shkurtër i institucionit dhe programit në vlerësim

- *Misioni dhe objektivat , programet e studimit që ofrohen*

UKZ u themelua me vendimin e Qeverisë së Kosovës numër 118/03 të datës 6 mars 2013, i cili nga KK u miratua më 30 maj 2013.

Vendimi i Kuvendit të Kosovës realizoi synimin dhe punën disa dekadëshe që është bërë në Gjilan me arsimin e lartë, prej vitit 1958 kur u themelua Qendra për Aftësimin e Mësimdhënësve (shkollë për përgatitjen e mësuesve).

Themelimi i UKZ-së bëri të mundur përfshirjen në shkollimin e lartë universitar të numrit më të madh të studentëve në Lindje të Kosovës, të Luginës së Preshevës (Serbi), rajonit të Kumanovës (Maqedonia Veriore) si dhe të viseve të tjera nga Kosova.

Më 10 dhjetor të vitit 2020 KK ka miratuar [Statutin e UKZ](#), me të cilin dokument, UKZ fiton pavarësinë administrative dhe përfundimisht bëhet i pavarur nga MASH.

UKZ bartë idenë e promovimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë universitar, kërkimeve shkencore, krijimtarisë artistike dhe kualifikimin e kuadrave deri në gradën e doktoraturës. Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan është krijuar për të qenë në shërbim të dijes, të edukimit dhe të mirëqenies së shoqërisë kosovare dhe të mbarë njerëzimit.

Mbështetur në vizionin dhe në misionin e vet, UKZ është ura lidhëse midis vlerave lokale, vlerave nacionale dhe vlerave globale. Ai është dera më e mirë e Kosovës për në epokën e teknologjisë dixhitale dhe për një shoqëri multikulturore. UKZ, duke i qëndruar besnik vetë thelbit të fjalës universal, do të nxisë dhe respektojë multikulturalizmin dhe diversitetin.

UKZ ka impakt të drejtpërdrejtë në shoqëri, dije, shkencë, familje, ekonomi, mirëqenia dhe në demokracinë e shoqërisë sonë e më gjerë. Të gjitha objektivat e UKZ, në përputhje me misionin e vet, orientohen drejt këtij roli të UKZ në shoqëri.

Misioni i UKZ është përshtatur me tre shtyllat kryesore: mësimdhënie, hulumtim dhe shërbim në komunitet. Në këtë drejtim, UKZ ka shënuar një progres të madh që nga akreditimi i fundit në vitin 2017:

- UKZ është bërë lidere në Kosovë në pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, sidomos në projektet e Erasmus+. Në vitin 2020 UKZ është pjesë e 9 projekteve të Erasmus+, prej të cilëve në 1 është grantmbajtës.
- UKZ ka krijuar një sistem të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë: janë krijuar politika për sigurimin e cilësisë, rregullore, trupa, mekanizma dhe instrumente që sigurojnë cilësinë
- UKZ ka orientuar programet studimore kah tregu i punës. Për cdo program të ri studimor ka një hulumtim paraprak të tregut të punës. Për këtë arsye UKZ i ka dhënë rol të rëndësishëm konsultimit me BKI, me studentët alumni dhe me hisedarë të tjerë të arsimit të lartë. UKZ ka orientuar sistemin e mësimin nga modeli memorizues kah mendimi kritik. Gjithnjë e më të rralla janë ligjëratat klasike në të cilat profesori shpjegon e studenti mëson. Studenti është në qendër, e kjo do të thotë se studentit merr rol edhe në ligjëratat, përmes XXX, përmes grupeve të diskutimit, përmes seminareve e detyrave të tjera të pavarura. Stafit akademik tashmë e kupton se në botën e teknologjisë informative shpjegimi klasik i profesorit në klasë nuk e ka rëndësinë e më parme, pasi studentit në çdo çast mund të ndjek të njëjtën ligjëratë nga shumë profesorë të tjerë në internet. Prandaj profesori duhet ta ndryshojë qasjen: ai duhet të nxisë studentët të mendojnë në mënyrë kritike për temat që synon t’ua shpjegojë, t’i nxisë vetë ata ta shpjegojnë dhe ta kuptojnë thelbin e temës. Në këtë mënyrë profesori shndërrohet në çelës të dijes, në vend të posedues dhe shpërndarës i dijes, si ka qenë që nga koha e Humanizmit dhe Renesancës.
- Në UKZ është zhvilluar një debat i gjerë për orientimin e UKZ edhe kah shkencat aplikative. Kjo ka rezultuar me formimin e Fakultetit të Shkencave Aplikative në vitin 2019 dhe me akreditimin e programit të parë aplikativ Matematika Arsimore.
- Në zhvillimin e programeve studimore të nivelit master UKZ ka sjellë risi në arsimin e lartë në Kosovë duke zhvilluar programe të përbashkëta edhe me dy universitete publike (Universiteti i Prizrenit dhe Universiteti i Pejës) dhe duke zhvilluar programe interdisciplinare në pronësi të tri fakulteteve të UKZ (FshK, FEK dhe FJu).
- UKZ ka ngritur Fakultetin e Shkencave Kompjuterike me sukses të madh, përmes të cilit ka pasur impakt të drejtpërdrejtë në shoqëri dhe në ekonomi: studentët e këtij fakulteti bashkëpunojnë me institucionet dhe bizneset, duke iu ofruar atyre shërbime në teknologji

informative, si psh. Krijimi i aplikacionit për funksionimin virtual të stacionit të autobusëve, të ueb faqeve të shkollave fillore, vendosja e paneleve digjitale në objektin e UKZ etj.

- UKZ i ka kaluar me sukses të gjitha proceset e deritashme të akreditimit.
- Në të gjitha rastet kur studentët e diplomuar të UKZ konkurrojnë në universitete të tjera në programe studimore master, ata renditen në krye të tabelave. Edhe në universitete ndërkombëtare ata kanë sukses dhe renditen në krye të tabelave, si psh. në Universitetin e Ohajos në SHBA, në Paderborn të Gjermanisë, në Universitetin e Gracit në Austri.
- Studentët e UKZ po tregohen të suksesshëm pas diplomimit edhe me hapjen e bizneseve dhe të ndërmrësive personale (shih [psh.](#))
- Vlerësimi i punëdhënësit për studentët e UKZ është pozitiv. Shumica e punëdhënësve shprehin se studentët tanë tregojnë një performancë të lartë që nga pranimi në punë.
- Kalimi nga mësimi klasik në mësimin onlajn, me rastin e pandemisë Covid 19, me c'rast UKZ iu desh vetëm një javë për të siguruar vazhdimësinë e këtij procesi tregon performancën e lartë të stafit akademik dhe të studentëve. Me atë rast, studentët u angazhuar t'i trajnojnë stafin akademik në përdorimin e platformave virtuale për mësim.
- UKZ ka ngritë stafin akademik dhe atë administrativ në sasi dhe në cilësi: në të dy grupet është rritur dukshëm numri i stafit, si akademik ashtu edhe administrativ. Në aspektin cilësor, shumica e asistentëve të UKZ kanë doktoruar dhe ata tashmë janë zgjedhur ose janë në proces të zgjedhjes profesor asistent. Në administratë është krijuar niveli i menaxherëve të mesëm, drejtorët dhe udhëheqësit e zyrave, të cilët nuk kanë ekzistuar në vitin 2017.
- UKZ ka rekrutuar staf akademik kryesisht të ri në moshë, e kjo dmth. të ambientuar me teknologjinë digjitale. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për procesin mësimor, por edhe për faktin se UKZ po synon t'i digjitalizojë të gjitha shërbimet studentore (tash për tash në kemi sistemin e menaxhimit elektronik SMU, orari digjital për organizimin e mësimin dhe të provimeve, e-learning, Moodle, google.meet etj.).

Në UKZ zbatohet organizimi i kurrikulave (planprogrameve studimore) bazuar në sistemin e tri cikleve të arsimit të lartë, Sistemin Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) dhe zbaton të gjitha rekomandimet e procesit të Bolonjës.

UKZ ka 5 (pesë) fakultete dhe 1 Njësi Organizative (Biblioteka Universitare) dhe aktualisht, në këto fakultete ofrohen 10 programe studimore: 8 programe të nivelit BA dhe 2 programe të nivelit MA

UKZ ka në proces të ri/akreditimit edhe 12 programe studimi, prej të cilave në proces të ri akreditim ka gjashtë programe: Fillor dhe Parashkollor (BA), Shkencat Kompjuterike (BA), Finance dhe Kontabilitet i Aplikuar (BA), E-qeverisje (MA), Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike (MA) si dhe për akreditim po ashtu ka në proces gjashtë programe të reja: Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (MA), Mësimdhënie e Kurrikula (MA), Kontrolla e Sistemeve dhe Inteligjenca Artificiale (MSC), Menaxhim dhe Ndërmarrësi (MSC), Juridiko-Penal (MSc), Administrimi dhe e Drejta e Unionit Evropian (BSc).

Me tabelën në vijim paraqesim fakultetet, emërtimet e programeve dhe gradave përkatëse që fitohen pas përfundimit të studimeve në këto programe:

Tabela 1: NJA dhe organizative të UKZ, numrin e programeve që ofrohen dhe gradat përkatëse që fitohen pas përfundimit të studimeve. (UKZ)

Nr.	Fakulteti	Programi i studimit	Niveli i studimit	Grada që fitohet
1.	Fakulteti i Edukimit	Parashkollor	BA	Bachelor i arsimit parashkollor
		Fillor	BA	Bachelor i arsimit fillor
2.	Fakulteti Juridik	Juridik i përgjithshëm	LLB	Jurist i diplomuar
3.	Fakulteti Ekonomik	Banka financa dhe kontabilitet	BSc	Bachelor i bankave financave dhe kontabilitetit
		Menaxhment	BSc	Bachelor i menaxhmentit
		Marketing	BSc	Bachelor i makertingut
4.	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Shkencat kompjuterike	BA	Bachelor i shkencave kompjuterike
5.	Fakulteti i Shkencave Aplikative	Matematikë Arsimore	BA	Bachelor i Matematikës Arsimore
6.	Fakulteti i Sh. Kompjuterike Fakulteti Juridik Fakulteti Ekonomik	E- Qeverisja	MA	Master i E- qeverisjes
7.	Universiteti i Gjilanit Universiteti i Prizrenit Universiteti i Pejës	Qeverisja lokale dhe shoqëria demokratike	MA	Master i Qeverisjes Lokale dhe Shoqërisë Demokratike

Në tabelën e mëposhtme jepet rrjedha e procesit të akreditimit të UKZ, si institucion dhe të programeve studimore:

Tabela 2: Procesi i akreditimit të UKZ dhe programeve studimore 2013-2021

<i>Faculty</i>	<i>Stady Program</i>	<i>First</i>	<i>Riakreditation</i>
Institutional Akreditation		2014	2017
Education	Preschool education (BA)	01.10.2014 - 30.09.2016	01.10.2016- 30.09.2020
	Primary Education (BA)	01.10.2014 - 30.09.2016	01.10.2016- 30.09.2020
Economy	Banc a Finance and Countable (BA)	01.10.2014 - 30.09.2017	01.10. 2017- 30.09.2021
	Management (BA)	01.10.2014 - 30.09.2016	01.10. 2016- 30.09.2020
	Marketing (BA)	01.10.2014 - 30.09.2017	01.10. 2017- 30.09.2021


Law	General Law (BA)	01.10.2014 30.09.2016	-	01.10.2016- 30.09.2020
Computer Sciences	Computer Sciences (BA) Specialities: IE and SEW	01.10.2014 30.09.2016	-	01.10.2016- 30.09.2020
Applied Sciences	Mathematics Education (BA)	1.10.2019- 30.11.2022		
Fcs - FEc-FLaw	e- government	01.10. 2017- 30.09.2021		
UKZ-UPZ-UHZ	Local Governance and Democratic Society	01.10. 2017- 30.09.2021		

- *Udhëheqja institucionale, strukturat e menaxhimit dhe marrëveshjet e administratës dhe personelit*

Universiteti organizohet dhe qeveriset në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, në bazë të Statutit të UKZ dhe në bazë të rregulloreve përkatëse të UKZ.

Universiteti përbëhet prej njësjive akademike, të cilat qeverisen dhe administrohen në tri shtylla kryesore: KD, Senati dhe administrata. Rektori është autoriteti kryesor menaxhues.


Organogrami i më poshtëm tregon për vendimmarrjen, llogaridhënien dhe kontrollin brenda sistemit administrativ të UKZ-së.



Organizimi i strukturave vendimmarrëse në çështjet akademike bëhet konform Statutit të Universitetit. KD merr vendime për hapjen dhe mbylljen e programeve studimore dhe njësjive akademike. Për të gjitha çështjet akademike vendos Senati i Universitetit, të cilin e kryeson rektori. Anëtarët e Senatit zgjidhen nga NJA të Universitetit, nga administrata dhe nga Parlamenti i Studentëve.

KF udhëheq dhe merr vendime për të gjitha çështjet akademike të Fakultetit. Dekani është menaxheri kryesor i Fakultetit dhe ai e prezanton Fakultetin në Senatin e UKZ

KF propozon programin studimor të ri i cili i dërgohet Komisionit të Studimeve për shqyrtim. Komisioni i Studimeve e shqyrton, e refuzon apo e propozon për miratim në Senatin e UKZ-së. Senati i UKZ-së e aprovon ose e refuzon propozimin e KF. Këtë mënyrë të organizimit e paraqesim në mënyrë skematike, si në vijim:



Emërimet e titujve për personelin akademik, bazuar në Statutin e UKZ-së, janë:

- Prof. dr. (profesor i rregullt)
- Prof. Asoc. dr. (profesor i asocuar)
- Prof. Ass. dr. (profesor asistent)
- Ligjërues
- Lektor
- korepetitor
- Ass. (asistent universiteti)

UKZ në vitin 2020 ka 45 staf akademik, prej të cilëve 2 janë ligjërues të lëndëve të arteve (Master of Arts), 4 janë asistentë (PhDcand.) dhe të tjerët janë doktor shkencash. Ky është një zhvillim i madh, kur të kihet parasysh fakti që në vitin 2016 UKZ ka pasur 4 profesorë me kontratë të plotë, 3 me gjysmë normë dhe disa asistentë. Gjatë këtyre viteve UKZ ka zhvilluar çdo vit akademik nga një konkurs për rekrutim të stafit të ri akademik dhe ka përkrahur asistentët që të përfundojnë me sukses studimet e doktoratës. Po ashtu, edhe 4 asistentët aktualë janë në prag të përfundimit të studimeve të doktoratës.

Edhe gjatë viti 2020/21 UKZ ka hapur konkursin për rekrutim edhe të 13 stafi të ri akademik.

Një kujdes të madh UKZ i ka kushtuar në këtë periudhë edhe avancimit të stafit akademik: gjatë vitit 2019/20 janë avancuar në tituj akademikë një numër i konsiderueshëm ti stafit akademik, e po ashtu edhe në vitin vijues 2020/21 është hapur konkursi për avancime të tjera. Të gjitha procedurat e avancimit bëhen në mënyrë transparente, duke respektuar në mënyrë strikte Rregulloren për pranimin në punë dhe avancimin e stafit akademik dhe udhëzimeve administrative të MASH, të cilat paraqesin revistat dhe platformat e indeksimit të revistave ku duhet të publikojë stafi akademik për avancim.

Stafi administrativ, përfshirë edhe sekretarin e përgjithshëm, i cili është menaxheri kryesor i administratës, ka 32 zyrtarë, të ndarë nëpër njësi të veçanta. Edhe në këtë pikë UKZ ka shënuar rezultat të prekshëm: në vitin 2016 UKZ ka pasur 16 zyrtarë administrativ dhe nga viti 2018 e kënde janë rekrutuar edhe 16 zyrtarë të tjerë, duke e bërë administratën e UKZ shumë më efektive. Po ashtu, UKZ ka një plan të rritjes edhe më tej të numrit të zyrtarëve, duke marrë me prioritet: Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Zyrën për Cilësi dhe Zhvillim Akademik, Bibliotekën Universitare etj. Po ashtu, UKZ ka planifikuar gjatë vitit 2021 edhe themelimin e Zyrës për Projekte, Zyrës për hulumtime Shkencore.

Kampusi i UKZ është në rrugën “Zija Shemsiu”, në qendër të Gjilanit. Ai përbëhet prej dy objekteve të mëdha, të bashkuara në rikonstruktim. Kampusi është në kufi me Kampusin e Shkollave të Mesme të qytetit, duke e shndërruar gjithë zonën në zonë shkollore, dhe universitare. Kampusi nuk i plotëson të gjitha nevojat në zhvillimin dinamik të UKZ, prandaj Komuna e Gjilanit dhe Qeveria e Kosovës janë duke gjetur një zgjidhje për një kampus të ri të universitetit, e po ashtu edhe brenda kampusit të tashëm në vitin 2020 janë shtuar hapësira të reja mësimore dhe bibliotekare.

- *Studentët e Universitetit “Kadri Zeka”, prejardhja e tyre socio-ekonomike dhe informatat përkatëse kontekstuale rreth fushës në të cilën vepron institucioni*

UKZ është i hapur dhe nxitë të gjithë kandidatët që plotësojnë kushtet formale për t’u regjistruar në studime universitare, në programet të cilat akreditohen. Studimet zhvillohen në gjuhën shqipe. Procesi mësimor në UKZ zhvillohet prej orës 8:30 deri në orën 18:00, ndërsa për studimet master vazhdon deri në ora 20:00.

Në konkursat e rregullta për pranimin e studentëve të rinj, ftohen kandidatët të cilët kanë të kryer shkollën e mesme, pa ndonjë kufizim gjinie apo përkatësie tjetër. Në bazë të Statutit të UKZ, realizohen dy konkurse për pranimin e studentëve të rinj, në qershor dhe shtator. Numri më i madh i studentëve është nga rajoni i Gjilanit, Kamenicës, Novobërdës, Vitisë, Ferizajit, Kaçanikut, Hanit të Elezit, Partesh, Klllokot, Ranillug, por edhe një numër i konsiderueshëm është nga rajonet e tjera të Kosovës, sidomos në programet master, si dhe nga Serbia (komunat: Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë) dhe nga Maqedonia Veriore (Kumanovë).

Pritet që për vitin akademik 2020/21 të ketë një interesim të shtuar nga studentët e rajonit të Kumanovës pasi që rruga Kumanovë-Gjilan është lëshuar për qarkullim me hapjen e pikëkalimit kufitar në [Stançiq mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut](#).

UKZ rezervon kuota të veçanta për pranimin e studentëve nga komunitetet e vogëla (serbë, turq, romë) apo nga komunat jashtë Kosovës (Serbi dhe Maqedoni e Veriut), si dhe lehtësira për pranimin e personave me nevoja të veçanta.

Që nga themelimi e deri më tash në UKZ janë regjistruar gjithsej 8174 studentë.

Viti akademi k Fakultet i	2013/1 4	2014/1 5	2015/1 6	2016/1 7	2017/1 8	2018/1 9	2019/2 0	2020/2 1	Total i
FEEd	401	210	277	221	202	196	167	199	1873
FJ	454	372	296	272	257	226	203	178	2258
FEk	608	608	497	386	245	244	234	235	3057
FShK		96	91	115	96	73	63	76	610
FShA							22	33	55
FShK, FEk, FJ: E-qever.					60	44	37	46	187
Juridik: QLSHD					50	28	22	34	134
Gjithsej	1463	1286	1161	994	910	811	748	801	8174

Tabela 3: Numri i studentëve të regjistruan në vitet 2013-2020

Prej 4904 studentëve të regjistruar deri në vitin 2016/17 kanë diplomuar gjithsej 1303 studentë, prej të cilëve 958 janë femra dhe 345 meshkuj, me një përqindje prej 26.6%.

Nga shifrat e mësipërme shihet një rënie e lehtë latente e studentëve të regjistruar dhe kjo shpjegohet:

- Me proceset globale dhe rajonale të migrimëve, ku Kosova nuk bënë përjashtim;
- Sepse në dy vitet e para 2013-2014 janë regjistruar një numër i madh i studentëve, të cilët kanë kaluar nga Universiteti I Prishtinës në UKZ.
- Sepse në dy vitet e para 2013-2014 janë pranuar një numër më i madh i studentëve (sipas vendimit të MASHT për vendet e rezervuara për komunitetet)
- Politikat e UKZ për zvogëlimin e kuotave të studentëve të pranuar në disa fakultete, si në Fakultetin Ekonomik dhe në Fakultetin Juridik;

Konkurrenca për një vend të studentit në UKZ është e madhe: në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, në Fakultetin e Edukimit, në programet master, në Fakultetin e Shkencave Aplikative konkurrenca shkon 3-4:1, pra ka tre deri në katër kandidat për një vend të studentit. Në disa programe të tjera studimore, si në Fakultetin Juridik dhe Fakultetin Ekonomik konkurrenca është më e vogël.

Një interesim të veçantë UKZ i ka kushtuar edhe marrëdhënies numerike profesor-student. Kështu që tashmë kemi një marrëdhënie relativisht të mirë, të afërt me mesataren europiane: 1 staf akademik me 21 studentë (1:21). Shih këtë marrëdhënie në vitin 2020:

Fakulteti	Programi studimit	Gjinia		Gjithsej Studentë	Staf akad. i rregullt	Staf akad. i angazhuar	Raport i St. Akad.-Studentit
		Femra	Meshkuj				
Fakulteti i Edukimit				744	11	17	28
	Fillor	405	44	449			
	Parashkollor	291	4	295			
Fakulteti Juridik	Juridik i përgjithshëm	383	191	574	10	18	28
Fakulteti Ekonomik				574	15	4	19
	Banka,Financa, dhe Kontabilitet	151	158	309			
	Menaxhment	77	46	123			
	Menaxhim dhe Ndërmarrësi	41	44	85			
	Menaxhment dhe Informatike	19	14	33			
	Marketing	18	6	24			
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Shkencat Kompjuterike	69	152	221	9	7	16
Fakulteti i Shkencave Aplikative	Matematika Arsimore	32	19	51	8	4	12
F. Ekonom. F. Jurid. FSHK	E-Qeverisja (master)	66	56	122		1	1
UKZ Gjilan UHZ Pejë UUH Prizr.	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike (master)	27	30	57		6	6
Gjithsejtë		1579	764	2343	45	57	1:22.97

Tabela 4: Numri i studentëve në raport me numrin e stafit të rregullt dhe stafit të angazhuar akademik në vitin 2020

Prejardhja socio-ekonomike e studentëve të UKZ-së ka dy karakteristika kryesore:

- Studentët e UKZ janë pothuajse të gjithë nxënës të cilat kanë kryer shkollimin e mesëm të lartë (12-vjeçar) dhe provimin e maturës (për të dy këto kualifikime merret numër i caktuar i pikëve të cilave u shtohen pikët e fituara në provimin pranues që e organizojnë fakultetet përkatëse);
- Nuk hetohet ndonjë dallim drastik i gjendjes ekonomike të studentëve, duke pasur parasysh që pagesa për regjistrimin e semestrave është i pranueshëm për studentët;
- Për studentët me gjendje të vështirë ekonomike, komnatat nga të cilat vijnë ata, ndajnë rregullisht bursa për studentët. Bursa për studentët e shkëlqyeshëm ndan edhe Universiteti, sikurse edhe MASH-i. Po ashtu edhe organizmat e tjerë, ndajnë bursa për kategori të studentëve të shkëlqyeshëm, për studentët me vështirësi ekonomike dhe të tjera;
- Numri më i madh i studentëve të cilët jetojnë jashtë Gjilanit, për t'i ndjekur ligjëratat dhe aktivitetet e tjera mësimore, udhëtojnë. Duke iu falënderuar pozitës së Gjilanit që është afër vendbanimeve të shumicës së studentëve dhe zhvillimit të hovshëm të kompanive të transportit publik, nuk hetohet ndonjë ngecje në këtë drejtim.

Vend të posaçëm në strukturat organizative i është kushtuar pjesëmarrjes së studentëve. Përfaqësimi i studentëve bëhet në të gjitha nivelet e menaxhimit të Universitetit dhe në të gjitha komisionet e përhershme. Për organizimin e aktiviteteve të studentëve, menaxhmenti i UKZ-së ka siguruar përkrahje të plotë, duke siguruar hapësirë të nevojshme dhe logjistikë tjetër të nevojshme.

UKZ ka një stabilitet dhe qëndrueshmëri financiare afatgjatë, pasi si universitet publik financohet prej buxhetit të Republikës së Kosovës. Granti qeveritar është fond i lejuar nga buxheti i Kosovës, i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore.

Qëllimi i UKZ është edhe ta nxis Qeverinë e Kosovës që ta themelojë një fond suplementar për financimin e universiteteve publike në mënyrë jo-lineare: një fond në të cilin universitetet konkurrojnë dhe [fitojnë grante në bazë të performancës së tyre hulumtuese, programore e të tjera.](#)

- *Mësimdhënia, mësimi dhe kurikula*

Mësimdhënia dhe mësimnxënia në programet studimore të UKZ bazohet, fillimisht në rregulloret e aprovuara nga ana e Senatit. Gjatë hartimit dhe përgatitjes së programeve studimore, e sidomos gjatë realizimit të procesit mësimor në këto programe, rol të rëndësishëm luan stimulimi dhe motivimi i studentëve në procesin mësimor, duke ofruar një varg të aktiviteteve: ofrimi i syllabuseve të lëndëve në fillim të semestrit, ligjëratat dhe ushtrimet me metoda fleksibile dhe me material të nevojshëm, organizimi i vlerësimeve periodike dhe të vazhdueshme, përdorimi i IT-së dhe aplikacionit e-learning, konsultimet e rregullta me mësimdhënësit etj. Në matjen e performancës së mësimdhënësve dhe të procesit mësimor, indikatorët kryesorë janë: vlerësimi i studentëve dhe rezultatet e arritura të studentëve, monitorimi i rregullte i procesit mësimor, etj. Në ngritje të rolit mbikqyrës të procesit akademik, menaxhmenti i UKZ ka vendosur në hyrjet e UKZ regjistrimin digjital për stafin akademik dhe stafin administrativ. Regjistrin e hyrje-daljeve të stafit e kontrollojnë dekanat e fakulteteve dhe sekretari gjeneral për administratën në baza javore, ndërsa gjetjet diskutohen edhe në takimet javore të rektorit me dekanët.

Mënyra e organizimit të procesit mësimor, si edhe vlerësimi i të arriturave të studentëve në studimet e programit Financë dhe Kontabilitet i aplikuar, bëhet konform vendimit Nr.011411, dt.05.08.2019, Rregullores për studime Bachelor (https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2017/06/RregullorePerStudimetThemeloreBacelor_FakultetiEkonom_622975.pdf)

Në Rregulloren e studimeve bachelor, janë përcaktuar organizimi i studimeve, kohëzgjatja e studimeve, kushtet e regjistrimit, kriteret e kalueshmërisë në vitin vijues, ndryshimin e programit të studimeve, kalimin nga/në fakultetet e tjera, organizimi i provimeve, të drejtat dhe detyrat e studentit, organizimi i studentëve, përfundimi i studimeve dhe diplomimi i studentëve etj.

Paraqitja e provimeve bëhet gjatë tri afateve të rregullta: në afatin e janarit - prej 15 deri më 20 janar, në afatin e qershorit - prej 1 deri më 5 qershor, në afatin e shtatorit - prej 20 deri më 30 gusht.

Mësimdhënësi është i detyruar që pas përfundimit të rezultateve përfundimtare të provimit, më së largu brenda 72 orësh t'ia dorëzojë zyrtarit të shërbimit të studentëve raportin e provimeve, bashkë me listën e studentëve si dhe kopjet fizike të fletëparaqitjeve të shkarkuara nga sistemi SMU. Format e mbajtjes së provimit janë: provimi me shkrim, provimi me gojë, provimi me shkrim dhe me gojë, provimi me test, provimi praktik dhe kolokuiumi.

Vlerësimi i provimit shprehet me notë:

Nota në UKZ	Përshkrimi me fjalë	Barasvlefshme me Sistemin e Bolonjës
10	shkëlqyeshëm	A,
9	Shkëlqyeshëm	B
8	Shkumë mirë	C
7	Mirë	D
6	Mjaftueshëm	E
5	pamjaftueshëm	F

Studentët duhet të arrijnë notën minimale 6 për kalueshmëri, që do të thotë se studentët duhet të arrijnë minimum 50% të notës përfundimtare për lëndët përkatëse.

Roli vendimmarrës i studentëve në strukturat organizative të UKZ-së zhvillohet nga pjesëmarrja e tyre në organet vendimmarrëse: Bazuar në Statutin e UKZ-së, dy përfaqësues të studentëve janë anëtarë me të drejtë vote në Senatin e UKZ; në Këshillin Drejtues është një anëtar – student-vëzhgues; në Komisionin për studime dy studentë me të drejtë vote; në Këshillin e Fakultetit studentët janë të përfaqësuar me nga një anëtar për secilën njësi akademike, me të drejtë vote. Për organizimin e aktiviteteve të studentëve, menaxhmenti i UKZ-së ka siguruar përkrahje të plotë, duke siguruar hapësirë të nevojshme dhe logjistikë tjetër të nevojshme.

Organizimi i procesit mësimor në UKZ është gjithnjë në funksion të politikave të Qeverisë për arsimin e lartë në Kosovë. Të gjitha vendimet e sjella nga MASH implementohen në UKZ.

Në UKZ zbatohet organizimi i kurrikulave (planprogrameve studimore) bazuar në sistemin e tri cikleve të arsimit të lartë, Sistemin Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) dhe zbaton të gjitha rekomandimet e procesit të Bolonjës.

Përcaktues i rendësishëm i punës në Universitetin “Kadri Zeka” është Startegjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimt të UKZ-së 2017-2023, e rishikuar dhe miratuar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. 02/2493 të dt.30.12.2020

Misioni i FAKULTETIT EKONOMIK

Misioni i programit të studimit është në përputhje me deklaratën e përgjithshme të misionit të UKZ-it, si dhe me misionin e FE si dhe akterëve tjerë nga industria, i cili në mënyrë të përmbledhur është si vijon:

Të përgatisë të diplomuar profesionalisht të aftë për të qenë pjesë e një shoqërie demokratike dhe tregu të punës në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe demokratik të vendit e më gjerë duke aplikuar në praktikë të arriturat bashkëkohore shkencore nga fusha e financës dhe kontabilitetit

Misioni i Fakultetit Ekonomik është harmonizuar konform misionit të UKZ-së, ku në formën aktuale është definuar në mbledhjen e fundit plenare të grupeve punuese të datës 22.01.2020 (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/fakulteti-ekonomik-i-ukz-se-ka-mbajtur-takim-pune-per-pergatitjet-rreth-akreditimit-te-programeve-studimore/>).

Fakultetit Ekonomik në Universitetin “Kadri Zeka”, përpos që u paraqit si nevojë e kohës e zhvilloj misionin e vetë edhe në edukimin dhe përgatitjen e kuadrove tejet të nevojshme, në radhë të parë për rajonin e Anamoraves, pastaj Kosoves, Lugines se Preshevës e më gjerë. Zhvillimi i metejm i FE, bazuar në hulumtimet e bëra nga FE, kërkon edhe programe të reja në harmoni me tregun e punës. Andaj përmes këtij raporti të vetëvlerësimit ofrojmë mundësi shtesë drejtë suksesit.

FE studenteve te vendit dhe regjionit u krijonë mundesi studimi, hulumtimi lidhur me dukurite ekonomike konform kerkesave aktuale te tregut te punes.

Fakulteti Ekonomik përmes rishikimit dhe zgjerimit të programeve arsimore, kërkimore si dhe ndërmarrëse të arrijë nivelet më të larta të arsimit te larte ne regjion përmes përgaditjes së menaxherëve,ndërmarrësve, ekonomistëve, kontabilistëve, financierëve kompetent për t’iu përgjigjur nevojave të shoqërisë dhe tregut të punës.

FE synon që programet e ofruara studimore të jenë në përputhje dhe harmoni me nevojat e tregut të punës, të jenë kompatible me Fakultetet Ekonomike të universiteteve tjera rajonale, evropiane dhe më gjerë, në mënyrë që studentet tanë të krijojnë aftësitë e kërkuara krijuese dhe ndërmarrëse.

UKZ, gjithashtu, synon të realizojë programe të reja studimore që do të kenë karakter multidisiplinar dhe do të krijojen në bashkëpunim me fakultetet brenda universiteteve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Të gjitha programet e reja që do të dërgohen për t’u akredituar në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, do te kenë studimin e fizibilitetit dhe asnjë program i ri nuk do të propozohet po qe se nuk do të përputhet me nevojat e tregut të punës.

Udhëheqja, menaxhimi dhe marrëveshjet e administratës dhe personelit

Njësia akademike e FE funksionon sipas Statutit të UKZ-i dhe ka strukturë organizative, funksionale dhe efikase.

Studentët, sfondin e tyre socio-ekonomik dhe informacionin përkatës kontekstual rreth zonës në të cilën ofrohet programi

Studentët që synohen për të studiuar në UKZ janë nga të gjitha trevat e Kosovës. Programet që ofrohen në këtë institucion janë unike dhe bëjnë diferencën në krahasim me insitucionet tjera të arsimit të lartë. Një numër i studentëve vijnë edhe nga viset tjera shqiptare, nga Maqedonia dhe Presheva, Bujanoci dhe Medvegja si dhe Mali i Zi.

Mësimdhënia, mësimi dhe kurikula

Qëllimi themelor në fushën e mësimdhënies është transmetimi tek studentët i një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore në aspektin teorik dhe praktik, duke realizuar ciklin «**informacion-njohuri-dije-aftësi**».

Mësimi - Forma e studimit është e rregullt. Fakulteti Ekonomik, për vitin akademik 2021-22 ka aplikuar për akreditim të programit Financë dhe Kontabilitet i aplikuar, që është vazhdimësi e programit të deritashëm Banka Financa dhe kontabilitet me disa ndryshime për sa i takon koncentrimin kryesor në financë dhe kontabilitet të aplikuar.

Viti akademik në FE përbëhet nga dy semestra me shtrirje në 15 javë secili. Kjo ndarje vlen për të dy nivelet e studimit në FE. Semestri i parë përfshin periudhën Tetor – Janar dhe semestri i dytë periudhën shkurt - qershor.

2 PROGRAMI: Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar

Emri i programit:

***Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar
Niveli: Bachelor - (BSc)
Ri-Akreditim***

PROGRAMI FINANCË DHE KONTABILITET I APLIKUAR

Qëllimet e programit

Qëllimi kryesor i programit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet të Aplikuar është që:

- *t'u japë studentëve njohuritë e nevojshme bazë në fushën e financave dhe kontabilitetit me qëllim formimin e profesionistëve të aftë për të punuar në këto fusha, si specialistë finance dhe kontabiliteti të njësive të vogla e të mesme të sektorit privat dhe publik duke aplikuar softuerëve bashkëkohore.*
- *të përgatisë të diplomuar të aftë për të vazhduar në nivele më të avancuara të studimeve*

Për këtë qëllim, kurikulat janë hartuar kërkesave bashkohore ekonomike duke marrë parasysh:

- mundësitë e punësimit të studentëve
- kërkesat e punëdhënësve;

Në vijim, prezantojmë të dhënat për programin për studime Bachelor - Financë dhe Kontabilitet i aplikuar

Kurikulat - Numri i lëndëve në total sipas shpërndarjes në semestër, për programin Financë dhe Kontabilitet i aplikuar për vitin akademik 2021-25, është paraqitur tek Tabela 1.

Tabela 5: Programi Financë dhe Kontabilitet i aplikuar (BSc)

Emri i programit të studimit	Financë dhe Kontabilitet i aplikuar
Niveli i kualifikimit sipas KKK me shkurtesat (BSc)	Bachelor i shkencave (BSc)
Grada akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar	Bachelor në Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar – - Koncentim në modulet financiare - Koncentrim në modulet e kontabilitetit të aplikuar Bsc në Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar - Koncentim në Financë - Koncentrim në Kontabilitet i Aplikuar
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC)	04.3
Profili i programit akademik (profilet)	Bachelor në Financë dhe Kontabilitet i aplikuar - Financë - Kontabilitet i aplikuar
Kohëzgjatja minimale e studimit	Tri (3) vite / 6 semestra
Forma e studimit (e rregullt, pa shkëputje nga puna, studim në distancë etj.)	I rregullt - pa shkëputje nga puna
Numri i ECTS kredive (total dhe për vit)	Total :180 ECTS Në Vit : 60 ECTS
Numri i vendeve të studimit	<ul style="list-style-type: none"> Financë dhe Kontabilitet i aplikuar (BSc), 200 student
Modulet /Lëndët (titujt)	<p style="text-align: center;">FINANCË DHE KONTABILITET I APLIKUAR</p> <p style="text-align: center;">Viti i parë – semestri I</p> <p>O Mikroekonomi O Matematikë për Ekonomistë O Parimet e Kontabilitetit O E drejta biznesore O Shkrim Akademik</p> <p style="text-align: center;">Viti i parë – semestri i II</p> <p>O Makroekonomi O Bazat e Statistikës O Bazat e Menaxhmentit</p>

O Anglishtja për biznes I
Z Integrimet Ekonomike në BE
Z Matematikë Financiare

Viti i dytë - semestri III

O Financa
O Sistemi tatimor
O Analiza statistikore financiare
O Bazat e kontabilitetit financiar
Z Marketing
Z Makroekonomi II
Z Anglishtja për Biznes II

Viti i dytë – semestri IV

O Financat Ndërkombëtare
O Financat e Korporatave
O Bazat e Kontabilitetit Menaxherial
O Tregjet dhe Institucionet Financiare
Z Ekonomiksi Monetar
Z Ekonomia e Kosovës dhe zhvillimi
Z Ekonomiksi i sektorit publik

Viti i tretë – semestri V

O Raportimi Financiar dhe SNRF
O Afarizëm Bankar
Module me zgjedhje për Financë (F)
Z Qeverisja e Korporatave
Z Sistemi monetar evropian
Z Financat Publike
Z Biznesi Ndërkombëtar
Module me zgjedhje për Kontabilitet i aplikuar (KA)
Z Softvere kontabiliteti
Z Analiza e pasqyrave financiare
Z Kontabiliteti Financiar
Z Kontabiliteti Menaxherial

Viti i tretë – semestri VI

O Auditimi dhe sistemi i kontrollit
O Menaxhimi Financiar
Module me zgjedhje për Financë (F)
Z Menaxhimi bankar
Z Menaxhimi i riskut dhe sigurimeve
Z Analiza e Investimeve
Module me zgjedhje për Kontabilitet i aplikuar (KA)
Z Aplikime kontabiliteti me softver
Z Kontabiliteti publik
Z Kontabiliteti i Institucioneve financiare
O Punim Diplome

Udhëheqësi i drejtimit / programit të studimit	Prof.Ass.Dr. Lutfi Zharku
Personeli i përhershëm akademik / artistik (Numri sipas kategorive të personelit)	<p>Profesorë të asocuar</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Prof.Asoc.Dr.Naim Mustafa 2. Prof.Asoc.Dr.Musa Ajeti <p>Profesorë asistentë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Prof.Ass.Dr.Xhevat Sopi 2. Prof.Ass.Dr.Shefket Jakupi, 3. Prof.Ass.Dr.Gezim Tosuni, 4. Prof.Ass.Dr.Bajram Fejzullahu 5. Prof.Ass.Dr.Fehmi Azemi 6. Prof.Ass.Dr.Lutfi Zharku 7. Prof.Ass.Dr.Arben Mustafa 8. Prof.Ass.Dr.Refik Kryeziu 9. Prof.Ass.Dr.Teuta Agaj 10. Prof.Dr.Sc Arben Sahiti 11. Prof.Dr.Sc Nexhat Shkodra <p>Asistentë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ass. Arbenita Kosumi, PhD (c) 2. Ass. Lulzim Rashiti, PhD (c)
Taksa e studimit	25 € për semestër

2.1 Misioni, objektivat dhe administrimi

Standardi 1.1.

Misioni i programit të studimit është në përputhje me deklaratën e përgjithshme të misionit të institucionit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Misioni i programit të studimit është në përputhje me deklaratën e përgjithshme të misionit të UKZ-it, bazuar në planin strategjik dhe me misionin e FE si dhe akterëve tjerë nga industria.

Kjo do të arrihet duke:

- Përgatitë të diplomuar me njohuri nga fusha e ekonomisë të cilat korespondojnë me nivelin bachelor të studimit.
- Përgadit të diplomuar qe kane shkathtesite dhe njohuri të duhura per shqyrtim të njohurive teorike dhe implementimin në praktikë.
- Përgatitë studente te afte per te kryer hulumtime profesionale si dhe hulumtime shkencore ne bashkepunim me stafin akademik.
- Të përgatitë student të cilët perms punësimit do të ndihmojnë zhvillimin ekonomik të vendit.

Standardi 1.2.

Këshilla relevante akademike dhe profesionale merren parasysh kur përcaktohen rezultatet e synuara të mësimit të cilat janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Rezultatet e mësimit që duhet të arrihen janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve 2020 dhe Kornizën e Kualifikimeve të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, sepse merren parasysh:

- Analiza e tregut të punës (shih: https://www.unsa.ba/sites/default/files/dodatak/2017-12/2016-higher-education-labour-market-balkans_en.pdf)
- Analize e raporteve statistikore për tregun e punës dhe kontakteve me partnerë nga industria (<https://ask.rks-gov.net/media/5803/statistikat-afatshkurtra-t%C3%AB-industris%C3%AB-tm3-2020.pdf> ; <https://ask.rks-gov.net/media/5766/anketa-strukture-e-nd%C3%ABrmarrjeve-asn-2019.pdf> ; <https://ask.rks-gov.net/media/5641/vjetari-2020-final-per-web-ang.pdf>).
- Diskutimeve në Këshillin e Fakultetit ku edhe merret iniciativa për realizimin e studimit bashkohor.
- Konsulenca me ekspert përkatës të fushës nga institucionet tjera akademike.
- Krahasimin me programet e tjera nderkombetare gjithnjë duke ju pershtatur nevojave të tregut vendor dhe rajonal.
- Involvimi i paleve të treta (me kompani private, publike, sektorin bankar dhe institucione të tjera), ku edhe nënshkruhen memorandumet e bashkepunimit përmes kontakteve të vazhdueshme informuese dhe punës praktike si pjesë e procesit të arritjes së rezultateve të synuara.

Standardi 1.3.

Programi i studimit ka një koncept të mire-përcaktuar didaktik dhe kërkimor.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Programi i studimit të propozuar për studime nivelit bachelor, Financë dhe Kontabilitet i aplikuar, është kompatibil me programet më të mira të fakulteteve ekonomike rajonale dhe më gjërë. Programi është konceptuar qartë dhe mire në aspektin didaktik sipas të gjitha parametrave të kërkuara, i cili është i përfaqësuar në syllabusët e lëndëve.

Studimi në këtë program do të ndjek një qasje të qëndrueshme shkencore bazuar në metodat didaktike bashkohore sipas parimit studentit në qendër me fokus përgatitjen e studentëve për tregun e punës por edhe për vazhdimin e nivele më të larta të studimit dhe kërkimit shkencor. Studentët do të aftësohen që të fitojnë njohuri, shkathtësi dhe kompetenca sipas objektivave të paracaktuara me rezultate të nxënies, si të programit ashtu edhe të lëndëve vec e vec.

Programi një komponentë të rëndësishme ia dedikon përgatitjes së studentëve për të zbatuar njohuritë teorike në praktikë, ku parasheh një masë të kënaqshme të lëndëve që kanë të bëjnë me këtë komponentë, ku do të mësohet aplikimi përmes softëverëve i programeve të ndryshme të kontabilitetit praktik.

Përveç lëndëve që kanë të bëjnë me softëverëve të kontabilitetit dhe sistemeve të informacionit financiar, edhe brenda lëndëve të tjera, janë parapara që të përfshihen njësi që kanë të bëjnë me realizimin praktike të njohurive dhe koncepteve teorike si dhe aplikimin e teknologjive moderne.

Standardi 1.4.

Ekzistojnë politika formale, udhëzime dhe rregullore që kanë të bëjnë me çështje të përsëritura procedurale ose akademike. Këto janë bërë publike për të gjithë stafin dhe studentët.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Ky standard arrihet bazuar në:

- Statutin e UKZ-it i cili është në harmoni të plotë me Ligjin mbi IAL dhe udhëzimet e MASH-it
- Rregulloret e brendshme të UKZ-së
- Rregulloret e brendshme të njesise akademike
- Dokumenteve të tjera relevante të UKZ-së dhe FE

Standardi 1.5.

I gjithë stafi dhe studentët janë në përputhje me rregulloret e brendshme që kanë të bëjnë me sjelljen etike në hulumtim, mësimdhënie dhe vlerësim në të gjitha aktivitetet akademike dhe administrative.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Ky standard përmbushet përmes rregulloreve në fuqi:

- Rregulloren për publikime në UKZ
- Rregulloren e sigurimit të cilësise dhe vlerësimit në UKZ
- Kodi i etikës i UKZ-it
- Rregulloret për studimet bachelor

I gjithë stafi dhe studentët janë të obliguar të veprojnë në përputhje me rregulloret e lartpërmendura.

Standardi 1.6.

Të gjitha politikat, rregulloret, termat e referencës dhe deklaratat e përgjegjësive në lidhje me menaxhimin dhe shpërndarjen e programit rishikohen së paku një herë në dy vjet dhe ndryshohen sipas nevojës së ndryshimit në rrethanat të caktuara.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Kjo praktikë tashmë është e instaluar në Fakultetin Ekonomik, ku si gjatë semestrit ashtu edhe pas përfundimit të tij diskutohet ecuria e mbarëvajtjes së procesit mësimor, vështrësit përparësitë dhe të meta.

P.sh. gjatë këtyre analizave vitin e kaluar akademik 2018/2019, Fakulteti Ekonomik, ka bërë një rishikim të stutrukturës programore dhe fondit të orëve për disa lëndë specifike pasi ka ardhur si kërkesë nga bartësit e lëndëve se fondi aktual i orëve nuk është i mjaftueshëm në raport me nevojat e studentëve. Kështu Këshilli i Fakultetit këtë kërkesë me propozimet përkatëse e ka përcjellë në Komisionin e Studimeve të UKZ.

Gjithashtu, për çdo fillim të semestrit bëhet rishikimi i syllabusëve, ku nga Këshilli i Fakultetit formohet një komision profesional, i cili bënë aprovimin e syllabusëve të rishikuar/përditësuar nga bartësit e lëndëve (<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2017/06/Vendim-i-Dekanit-per-emerimin-e-Komisionit-per-Syllabuset.docx.pdf>).

Tabela 6: Analiza SWOT për misionin, objektivat dhe administrimin:

A. Pikat e forta	B. Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Misioni i FE në kuadër të Universitetit KADRI ZEKA, është qartë i definuar dhe i orientuar nga profilizimi i studimeve në fushën e Financë dhe Kontabilitet i aplikuar, ▪ Bashkepunimi me Bordin Industrial, alumnit dhe studentet aktual ka krijuar përparësi për të përcaktuar një program studimi me profilet që janë konform me kërkesat e tregut të punës. ▪ Mesimdhënia bazohet në konceptet e definuara qartë didaktike dhe hulumtuese. ▪ Zbatimi i programi studimor sipas standardeve të përcaktuara përcillet në vazhdimësi. ▪ Fakulteti Ekonomik në programin e ofruar studimor ka bërë diferencimin nga universitetet tjera. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mundësia e kufizuar buxhetore e Fakultetit për të përkrahur studentët për praktiken profesionale dhe vizita nëpër biznese, institucione apo edhe universitetet të tjera rajonale me qëllim të shkëmbimit të përvojave. ▪ Mungesa e literaturës sipas kurikulave të reja në gjuhën shqipe; ▪ Nevoja permanente e stafit akademik në përforcimin e gjuhëve të huaja.
C. Mundësitë	D. Sfidat
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ekziston qasje pozitive e bizneseve dhe institucioneve publike për bashkepunim në aspekt të avansimit përmes punëtorive, seminareve, praktikës profesionale etj. ▪ Në bazë të takimeve të zhvilluar me biznese ekziston interesim i shtuar me programet e reja. ▪ Fryma pozitive e bizneseve për bashkëpunim me FE jep mundësi që ta përcjellim konceptin e ndërmarrësisë në bizneset e rajonit dhe përmes hulumtimeve të përbashkëta të ngrisim kapacitetet e studentëve. ▪ Hulumtimet me alumni japin indikacione për mundësi të zhvillimit të bizneseve të reja nga vetë studentët e diplomuar, 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Buxheti i limituar nga qeveria ▪ Ngjashmëria me programet studimore me FE të universiteteve tjera. ▪ Gjendja ekonomiko-sociale jo e mirë e vendit në sferën e punësimit. Cilësia e studentëve të rinj; ▪ Zvogëlimi i numrit të studentëve; ▪ Numër i pamjaftueshëm i stafit akademik të rregullt si mungesë e buxhetit nga MASH.

<p>prandaj programi me kurrikulën e paraparë do tu krijoj këtë mundësi. Shkëmbime të studentëve dhe të stafit me universitete të njohura rajonale dhe më gjerë;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zgjerimi i bashkëpunimeve me Institucione të Arsimit të Lartë në rajon dhe me gjerë. 	
--	--

2.2 Menaxhimi i cilësisë

UKZ, ka të miratuar politikat e sigurimit të cilësisë brenda institucionit, të cilat janë dokumente publike. Përmes këtyre masave të sigurimit të cilësisë definojnë të gjitha proceset, mekanizmat, instrumentet, raportimet, grumbullimet e të dhënave, afatet kohore, cikli i të siguruarit të cilësisë si dhe të gjitha përgjegjësitë e individëve dhe njërive të përfshira në procesin e sigurimit të cilësisë.

Përmes këtyre politikave të sigurimit të cilësisë në nivel institucioni është i përcaktuar sigurimi i cilësisë duke përfshirë strategjinë për sigurimin e cilësisë, strukturën organizative për sigurimin e cilësisë, subjektet e sigurimit të cilësisë, programet studimore, procesin arsimor, punën hulumtuese, resurset njerëzore, studentët, literaturën, hapësirën arsimore, çështjen e financimeve, menaxhimin e institucionit si dhe përfshirjen e studentëve në procesin e sigurimit dhe avancimit të cilësisë së punës.

Skema në vijim pasqyron në mënyrë të plotë sistemin e sigurimit të cilësisë në UKZ.



Tabela 7: Sistemi i Sigurimit të Cilësisë në UKZ

Në Fakultetin Ekonomik, sigurimi i cilësisë bazohet në:

- [Rregulloren pwr sigurimin e cilësisë](#) dhe vlerësimin në UKZ
- [Manualin](#) për planifikim dhe vlerësim të performancës së stafit akademik në UKZ
- Urdhërrëfyesin për Sigurimin të Jashtëm të Cilësisë

Standardi 2.1.

I gjithë stafi merr pjesë në vetë-vlerësime dhe bashkëpunon me proceset e raportimit dhe përmirësimit në sferën e tyre të veprimtarisë.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Në bazë të kërkesave të zyres së cilësisë i gjithë stafi i FE merr pjesë në vetë-vlerësime dhe është pjesë e proceseve të raportimit dhe përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimënxënie :

- Një herë në vit bëhet vlerësimi i gjithë stafit akademik dhe administrativ nga ana e studentëve
- Një herë në vit bëhet vetëvlerësimi i gjithë stafit akademik
- Një herë në vit bëhet vlerësimi i stafit akademik nga menaxhmenti
- Prodekani dhe kordinatori për cilësi monitorojnë mbarevajtjen e procesit mesimor dhe implementimin e kurikules.
- Të dhënat nga pikat e mesiperme perpunohen nga Zyra qendrore e cilësisë dhe informacionet e gjeneruara shpërndahen të udhëheqesi i njësive dhe të kordinatori i cilësisë.
- Pas analizimit të informacioneve nga dekani dhe kordinatori i cilësisë, raportet perkatëse u shpërndahen stafit akademik dhe administrativ dhe diskutohen veç e veç me secilin staf.
- Raporti i përgjithshëm diskutohet në Keshillin e Fakultetit.
- Në fillim të çdo viti akademik bëhet përditësimi i përmbajtjes së syllabuseve në rastet e nevojshme
- Rezultatet e nxjerra nga pyetësi analizohen në nivel qendror të Universitetit për t'u transmetuar në menaxhmentin e njësive deri tek profesori përkatës. Në bazë të rezultateve të dalta ndërmerren masat konkrete me qëllim të ngritjes së cilësisë.
- Rezultatet e gjeneruara nga pyetësi janë shumë të rëndësishme për vendimmarrje si dhe për të bërë me dije mënyrën e funksionimit dhe aspektet të cilat kanë nevojë për më shumë vëmendje.
- Vlerësimi i mësimdhënësve bëhet përmes pyetësit, i cili u shpërndahet studentëve nga zyra e cilësisë në UKZ.

Kjo punë kryhet duke u bazuar në Manualin për planifikim dhe vlerësim të performancës së stafit akademik në UKZ

Standardi 2.2.

Proceset e vlerësimit dhe planifikimi për përmirësim janë integruar në proceset normale të planifikimit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Në UKZ dhe pastaj në Fakultetin Ekonomik, aspekti i sigurimit të cilësisë është i theksuar si komponentët e rëndësishme dhe është pjesë integrale e çdo procesi të planifikimit për zhvillim. Ato marrin për bazë rezultatet e gjeneruara nga monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm që i bëhet cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe shërbejnë si rekomandime dhe janë pjesë perberese e planifikimit për vitin e ardhshëm akademik me qëllim të ngritjes së cilësisë.

Koordinatori për cilësi, pas evidencës që merr nga monitorimi i vazhdueshëm, në Këshillin e Fakultetit përcjell nevojat për ndryshim në pika të veçanta të procesit, të cilat diskutohen në Këshill dhe nga aty dalin konkluzionet dhe rekomandimet e KF.

Standardi 2.3.

Proceset e sigurimit të cilësisë merren me të gjitha aspektet e planifikimit dhe ofrimit të programeve, duke përfshirë shërbimet dhe burimet e siguruar nga pjesë të tjera të institucionit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Në UKZ është e përcaktuar dhe avancohet vazhdimisht aspekti i sigurimit të cilësisë, duke u ngritur edhe kapacitete e nevojshme. Sigurimi i cilësisë është proces gjithëpërfshirës i cili zhvillohet në dy kahje, nga UKZ drejt FE dhe e kundërta.

Në të dy nivelet ekzistojnë personat përgjegjës, zyret përgjegjëse për cilësi të cilat në mënyrë permanente përcjellin ndryshimet në nivel të Institucionit dhe njësisë akademike bazuar në dokumente relevante për cilësi.

Kështu në nivel të Universitetit është ngritur Zyra për Zhvillim Akademik dhe është formuar Këshilli për mbikeqyrjen e cilësisë dhe për vlerësim sipas Rregullores për themelimin dhe funksionimin e [Këshillit për mbikeqyrjen e cilësisë dhe për vlerësim](#) kurse në nivel të Fakultetit është emëruar [Koordinatori për Cilësi](#)

Standardi 2.4.

Vlerësimet e cilësisë ofrojnë një përmbledhje të çështjeve të cilësisë për programin e përgjithshëm, si dhe të komponentëve të ndryshëm brenda tij; vlerësimet konsiderojnë të dhëna, procese dhe rezultate, me vëmendje të veçantë për rezultatet e të nxënit për studentët.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Nga niveli i mësimdhënies dhe Fakultetit, vlerësimi i cilësisë për programin konsiston në përgatitjen dhe përshtatje të syllabusëve që të jenë në funksion të ngritjes së cilësisë dhe arritjes së qëllimeve të tyre dhe objektivit të përgjithshëm të programit.

Në këtë drejtim përmbajtja e syllabusëve ([shih në shtojca](#)) është e qartësuar si sa i përket qëllimit të lëndës dhe metodologjisë që aplikohet në tërësi ashtu edhe për sa i përket rezultatet të pritura (learning outcomes) dhe vlerësimit të tyre.

Koordinatori për cilësi do të bëjë në mënyrë të vazhdueshme për çdo afat, duke filluar nga Afati i Janarit 2020, analizën e kalueshmërisë në provime dhe rezultatet do të diskutohen në Këshillin e Fakultetit, nga ku do të dalin konkluzione dhe rekomandime .

UKZ kryen vlerësimin e lëndëve në mënyrë të standardizuar dhe transparente. Këto udhëzime qartë rregullojnë mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të fituara gjatë vlerësimit të stafit akademik si dhe lëndëve . Ato zbatohen për të gjithë stafin akademik (duke përfshirë ligjëruesit dhe asistentët mësimdhënës) pavarësisht nga thirrja e shkencore apo pozita e tyre. Në veçanti, rezultatet e vlerësimit i ndihmojnë mësimdhënësit dhe njësisë akademike të vetëpërmisohen në mënyrë të vazhdueshme. Në rastet kur personeli akademik nuk ka aftësi ose vullnet për t'u përmirësuar, universiteti do të vendosë masa/sanksione, p.sh. caktimin e detyrave/aktiviteteve tjera.

Standardi 2.5.

Proceset e sigurimit të cilësisë sigurojnë se janë përmbushur standardet e kërkuara dhe se ka përmirësim të vazhdueshëm të performancës.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Proceset e sigurimit të cilësisë paraqesin një pasqyrë të performancës së arritur dhe tregojnë se standardet e sigurimit të cilësisë janë përmbushur si dhe mundësojnë detektimin e fushave për përmirësim të cilat ndikojnë në ngritjen e vazhdueshme të performancës. Me këtë rast rishikohen:

- Përmbajtja e programit në dritën e hulumtimeve më reja, duke siguruar që programi është i përditësuar;
- Ngarkesën mësimore, progresin dhe kompletimin e studentëve me dije;
- Efektshmërinë e procedurave të vlerësimit për studentët;
- Pritshmëritë, nevojat dhe kënaqshmërinë e studentëve në lidhje me programin e realizuar;

FE me rastin e hartimit dhe zbatimit të proceseve të sigurimit të cilësisë u mundëson edhe studentëve të marrin pjesë në këto procese në bashkëpunim me stafin akademik dhe zyrën e cilësisë e cila funksionon në kuadër të UKZ-it.

Përmes formave të ndryshme: si ofrimi i teknologjisë së njetueshme, formave të tjera të trajnimit të stafit akademik, sigurimit të literaturës adekuate dhe aktiviteteve të tjera, zyra për cilësi në formë permanente mundohet të siguroj kushtet ku cilësia do të vijë në shprehje.

Standardi 2.6.

Të dhënat e anketimit të mbledhura nga studentët, të diplomuarit dhe punëdhënësit bëhen publike.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

ZZhAC, publikon rezultatet e hulumtimit në këtë mënyrë: Secilit mësimdhënës të vlerësuar i dërgohen rezultatet e tij në mënyrë elektronike, studentët marrin informacion rreth vlerësimit përmes raporteve të shprehura gojarisht nga dekani dhe mësimdhënësit, Dekanët dhe Prodekanët marrin të gjitha rezultatet për fakultetin e tyre, kurse Rektori dhe Prorektorët marrin të gjitha rezultatet për Universitetin. [Raporti përmbledhës 1](#) dhe [2](#) publikohet në ëeb faqen e Universitetit.

Në kuadër të UKZ-it është themeluar Alumni i të diplomuarve në mënyrë që të mbahet lidhja dhe korespondenca me ish studentët e diplomuar. Kurse Fakultetit Ekonomik ka vendosur një nivel më të ngushtë të bashkëpunimit ë alumnit dhe industrinë.

Në këtë drejtim, është realizuar edhe një hulumtim me ta ku të dhënat janë publikuar në web:

[Link 1](#) [Link 2](#)

Standardi 2.7.

Për zhvillim të programeve të mëtejme të studimit janë marr parasysh edhe rezultatet e sigurimit të cilësisë. Kjo përfshin rezultatet e vlerësimit, ngarkesen e studentëve, suksesin akademik dhe punësimin e të diplomuarve.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Zhvillimi i këtij programi konsiston edhe në analizën për sa i përket cilësisë, raporteve të Zyrës për Zhvillim Akademik dhe rezultatetve të pyetsorëve ku janë evidentuar pika të cilat i kanë fokusuar studnëtët. Një aspekt i rëndësishëm gjatë hartimit të këtij programi, për sa i takon komponentës së cilësisë është marrë edhe nga rezultatet e hulumtit me studentët alumni, sic u theksua në në satndardin 2.6.

Këto rezultate dhe diskutimet e vazhdueshme në Këshillin e Fakultetit për sa i përket cilësisë kanë shërbyer si një platformë solide për përgatitjen e këtij programi i cili ka inkorporuar të gjeturat dhe konkluzionet që kanë dalë prej tyre. Në këtë drejtim janë rishikuar dhe theksuar metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi i rezultateve duke vënë theksin në inkorporimin e këtyre aktiviteteve:

- Vijueshmeria e studenteve
- Aktivitetet e studenteve gjate procesit mesimor
- Vleresimet mes semestrave me shkrim
- Nje pjese e vleresimit behet nga asistenti i lendes
- Punimet seminarike / projektet
- Vleresimi (provimi) final

Gjithashtu nga analiza e mësimëprmes është rregulluar edhe ngarkesa e studenteve ku janë harmonizuar orët e punës në raport me ECTS-te.

Standardi 2.8.

Institucioni siguron që raportet mbi cilësinë e përgjithshme të programit të përgatitjen për shqyrtim në mënyrë periodike (p.sh. çdo tre vjet) duke treguar forcën dhe dobësitë e tij.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Raportet mbi cilësinë e përgjithshme të programit përgaditen për çdo vit si dhe rekomandimet e dalura inkorporohen në RVV si pjesë e procesit të riakreditimit i cili bëhet çdo tre vite për programet perkatese. Këtu merren parasysh edhe rekomandimet e dalura nga raportet e eksperteve të caktuara nga AKA si rezultat i vlerësimeve paraprake të jashtme.

Këtë e dëshmon fakti se programi i ri i ofruar për akreditim është një program i ri që nuk ka qenë më parë. Program me dy profile të reja.

Nga dy profilet e reja, njëri është krejtësisht i ri kurse tjetri posedon elemente të programit të kaluar por që përbazë ka rekomandimet e ekspertëve, të cilët sipas nevojës në të ardhmen çdo tre vjetë do të rishqyrtohen duke i shqyrtuar përparësitë dhe dobësitë e programeve.

Standardi 2.9.

Rregullimet e sigurimit të cilësisë për programin vetë vlerësohen dhe përmirësohen rregullisht.

Zyra për Zhvillimin Akademik, Komisioni për Sigurimin e Cilësisë dhe koordinatorët e cilësisë nëpër fakultet e UKZ, në mënyrë të vazhdueshme monitorojnë procesin dhe vëjnë vetëvlerësimin dhe përmirësimet e nevojshme për sa i përkatë mekanizmave për sigurimin e cilësisë. Lidhjen e ngushtë mes Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Fakultetit e mban koordinatori i cilësisë. Gjithashtu aspektet e cilësisë kalojnë dhe rirregullimet e nevojshme kalojnë edhe nëpër hallka të tjera të organizimit të Universitetit ku përfshihen të gjithë akterët, nga menaxhmenti i lartë, e deri te studentët.

Tabela 8: Analiza SWOT për sigurimin e cilësisë:

A. Pikat e forta	B. Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet e vlerësimeve adresohen nga menaxhmenti • Plan programet rishikohen në baza të rregullta ose me rastin e akreditimit, • Syllabuset harmonizohen mes vete që të mos ketë dyfishime të përmbajtjeve akademike • Avancimi i sistemit te menaxhimit të universitetit (SMU) • Themelimi i asociacionit ALUMNI si menyre e marrjes se komenteve per permiresim nga studentet e diplomuar • Përfaqësim i studentëve në strukturat menaxhuese (Senati, Këshillin e FE) • Egzistimi i koordinatorëve për sigurimin e cilësisë për kontrollin permanent të cilësisë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Infrastruktura e pamjaftueshme dhe e papershtatshme për procesin mesimor. • Mungesa e mjeteve financiare në avansimin e sigurimit cilësisë. • Pamjaftueshmëria e qasjes në libraritë dhe databazat elektronike • Hezitimi i akterëve (stafi akademik, stafi administrativ dhe studentët) në deklaram të cilësisë.
C. Mundësit	D. Sfidat
<ul style="list-style-type: none"> • Bashkpunimi me bizneset dhe institucionet publike është i mirëpritur në përparimin e cilësisë të programeve studimore. • Vizita dhe trajnimet e studentëve jashtë vendit në këmbim të përvojave • Digjitalizimi i proceseve të vlerësimit të cilësisë dhe performances; • Qasja në biblioteka elektronike; 	<ul style="list-style-type: none"> • Fondet e dedikuara për menaxhim të cilësisë; • Programet për menaxhim më efikas të bazës së të dhënave për menaxhim të cilësisë. • Adaptimi ne kriteret e reja qe kerkon reformimi drejt standardeve bashkekohore.

2.3 Stafi akademik

Standardi 3.1.

Kandidatët për punësim sigurohen me përshkrime të plota pozicioni dhe kushtet e punësimit. Të prezantohen në formë tabelare të dhënat për stafin akademik/ artistic Full Time (FT) dhe Part Time (PT) që përfshijnë: emrin, kualifikimin, titullin akademik, kohëzgjatjen e kontratës (së vlefshme) zyrtare, ngarkesa për mësimdhënie, provimet, konsultimet, aktivitetet administrative, hulumtimet, etj. për programin e studimit nën vlerësim.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Fillimisht personeli akademik i FE është angazhuar nga UKZ-i, në marrëdhënie të rregullt pune dhe UP në marrëdhënie sekondare të punës në bazë të marrveshies në mes të këtyre dy institucioneve.

Tashmë me kontratë të rregullt pune i kemi 12 doktor shkencash (Prof Asoc Dr.; Prof.Ass.Dr) nga lëmi i ekonomisë dhe dy PhD kandidat. Shumica profesorëve dhe asistentëve dhe disa ligjërues kanë fituar titujt shkencor në Universitete të njohura evropiane duke ndikuar dukshëm në qasjen dhe cilësinë e mësimdhënies dhe të aktivitetit shkencor në Fakultetin Ekonomik.

Personeli mësimor zhvillonë strategji për përmirësimin e mësimdhënies së vet dhe të mbanë shënimin e provave të vlerësimeve dhe strategjive për përmirësim.

Për programin Financë dhe Kontabilitet i aplikuar numri i stafit mësimdhënës të rregullt, është prezantuar në tabelën në vijim:

Tabela 9: Të dhënat në formë tabelare për stafin akademik - Full Time (FT)

Emrin dhe mbiemrin	Kualifikimi (grada shkencore)	Thirrja akademike	kohëzgjatjen e kontratës (K.Z*)	ngarkesa për mësimdhënie	aktivitetet administrative	Hulumtimet
Xhevat Sopi	Dr.(doctor) Ekonomiks	Prof.Ass.	05.12.2020	me orar të plotë / Full Time	Në përputhje me statutin e UKZ-it dhe rregulloret e brendshme	Shihë tabelën në shtojcën
Shefket Jakupi	Dr.(doctor) Ekonomi-Finance-Kontabilitet	Prof.Ass.	30.09.2023	me orar të plotë / Full Time		
Naim Mustafa	Dr.(doctor) Ekonomi-Menaxhment	Prof.Asoc.	14.02.2024	me orar të plotë / Full Time		
Bajram Fejzullahu	Dr.(doctor) Ekonomi-Menaxhment	Prof.Ass.	30.09.2023	me orar të plotë / Full Time		
Fehmi Azemi	Dr.(doctor) Ekonomi-menaxhment	Prof.Ass.	30.09.2023	me orar të plotë / Full Time		
Gezim Tosuni	Dr.(doctor) Ekonomi-	Prof.Ass.	30.09.2023	me orar të plotë / Full Time		
Arben Mustafa	Dr.(doctor) Ekonomi-	Prof.Ass.,	30.09.2023	me orar të plotë / Full Time		

Teuta Agaj	<i>Dr.(doctor)</i> Gjuhë angleze-	<i>Prof.Ass.</i> ,	30.09.2023	<i>me orar të plotë / Full Time</i>		
Refik Kryeziu	<i>Dr.(doctor)</i> Ekonomi- Financa	<i>Prof.Ass.</i> ,	14.02.2020	<i>me orar të plotë / Full Time</i>		
Musa Ajeti	<i>Dr.(doctor)</i> Matematikë	<i>Prof.Asoc</i>	14.02.2024	<i>me orar të plotë / Full Time</i>		
Arben Sahiti	<i>Dr.(doctor)</i> Ekonomi-Banke, Finnace dhe Kontabilitet	Asistent,	30.09.2021	<i>me orar të plotë / Full Time</i>		
Nexhat Shkodra	<i>Dr.(doctor)</i> Ekonomiks ekonomiks	Asistent,	05.12.2023	<i>me orar të plotë / Full Time</i>		
Arbenita Kosumi	<i>Mr / PhD (c)</i> Ekonomi-Banke, Finnace dhe Kontabilitet	Asistent,	30.09.2021	<i>me orar të plotë / Full Time</i>		
Lulzim Rashiti	<i>Mr / PhD (c)</i> Ekonomi- marketing	Asistent,	30.09.2021	<i>me orar të plotë / Full Time</i>		

*Kontratat Zyrtare të punës janë pjesë përbërëse e dosjes së sëjçilit anëtarë të personelit arsimor; ** norma (+ mbi normë)

Tabela 10: Rekapitullimi i stafit akademik - Full Time (FT)

Rekapitullimi i stafit akademik - Full Time (FT)					
Perhershem:	Prof. rregullt	Prof. asocuar	Prof.asistent	Prof.Dr.Sc	Asistent
Financë dhe Kontabilitet i aplikuar	0	2	10	2	2
Totali	0	2	10	2	2

Ndërsa në vijim, prezantojmë stafin e jashtëm, të angazhuar në Fakultetin Ekonomik

Tabela 11: Të dhënat në formë tabelare për stafin akademik - Part Time (PT)

<i>Emrin dhe mbiemrin</i>	<i>kualifikimin</i>	<i>titullin akademik dhe grada</i>	<i>Kontratë mbi vepër (K. Z.**)</i>	<i>ngarkesa për mësimdhënie</i>	<i>aktivitetet administrative provimet, konsultimet</i>	<i>Hulumtimet-</i>
<i>Skender Ahmeti</i>	<i>Dr.(doctor)</i> Ekonomi- Banke, Finnace dhe Kontabilitet	<i>Prof.Dr</i>	<i>1 vit</i>	<i>Me angazhim</i>	<i>Në përputhje me statutin e UKZ-it dhe rregulloret e brendshme</i>	<i>Shihë tabelën në shtojcën</i>
<i>Art Shala</i>	<i>Dr.(doctor)</i> Marketing	<i>Dr.sc.</i>	<i>1 vit</i>	<i>Me angazhim</i>		
<i>Liridon Dalipi</i>	<i>Dr.(doctor)</i> Juridik	<i>Prof.Ass.</i>	<i>1 rregullt UKZ</i>	<i>Me angazhim</i>		

<i>Ragmi Mustafa</i>	<i>Dr.(doctor) Shkenca Kompjuterike</i>	<i>Prof.Ass</i>	<i>I rregullt UKZ</i>	<i>Me angazhim</i>		
<i>Basri Ahmedi</i>	<i>Dr.(doctor) Shkenca Kompjuterike</i>	<i>Prof.Ass</i>	<i>I rregullt UKZ</i>	<i>Me angazhim</i>		
<i>Detrina Alishani</i>	<i>Mr/ PhD (c) Juridik</i>	<i>Asistent</i>	<i>I rregullt UKZ</i>	<i>Me angazhim</i>		

* Kontratë Zyrtare, ** Kontratë mbi vepër (Pjesë të ligjëratave)

Tabela 12: Rekapitullimi i stafit akademik - Part Time (PT)

Rekapitullimi i stafit akademik - Part Time (PT)						
Jashtëm	Prof. dr.	Prof. asocuar	Prof.asistent	Ligjerues	Asistent	
Financë dhe Kontabilitet i aplikuar	1	0	3	1	1	
Totali	1	0	3	1	1	

Standardi 3.2.

Stafi mësimor duhet të jetë në përputhje me kërkesat ligjore lidhur me profesionin pozitave mësimore të përfshira në Udhëzimin Administrativ për Akreditim.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Stafi mësimor FE është i kualifikuar me grada shkencore Doctor dhe thirrje akademike Prof.Ass., në përputhje me kërkesat ligjore lidhur me profesionin dhe pozitat mësimore të parapara sipas Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë Republikën e Kosovës, të dates 28.09.2018

Aktualisht dy profesor janë ne proces te avancimit te tyre nga thirrjet akademike Prof.Ass. ne Prof. Asoc., dhe dy asisistent janë ne proces te avancimit te tyre në thirrjet akademike Prof.Ass., ku tw gjithw kane marre vleresimine komisioneve përkatëse

Programet e trajnimit për aftësi të mësimdhënies ofrohen në vazhdimësi për stafin mësimdhënies, duke përfshirë ato me përgjegjësi për mësimdhënien dhe në përdorimin efektiv të teknologjisë së re në mësimdhënie.

Standardi 3.3.

Stafi akademik nuk mbulon, brenda një viti akademik, më shumë se dy pozita mësimore (një me orar të plotë, një kohë të pjesshme), pavarësisht nga institucioni arsimor ku ata kryejnë veprimtarinë e tyre.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Stafi akademik nuk mbulon brenda një viti akademik më shumë se dy pozita mësimore (një me orar të plotë, një kohë të pjesshme), pavarësisht nga institucioni arsimor ku ata kryejnë veprimtarinë e tyre konform Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë Republikën e Kosovës, të dates 28.09.2018.

Personeli mësimor është i përfshirë në zhvillimin profesional për të përmirësuar cilësisë në mësimdhëni, si dhe është duke u monitoruar nga menaxhmenti FE.

Standardi 3.4.

Të paktën 50% e stafit akademik në programin e studimit janë punonjës me kohë të plotë dhe përbëjnë të paktën 50% të klasave të programit të studimit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Stafi akademik i FE janë punonjës të përhershëm të punësuar me orar të plotë dhe përbëjnë mbi 66% të orëve mësimore të programit të studimit, sipas nenit 26, pika 5.3.3 Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë Republikën e Kosovës, të dates 28.09.2018

Standardi 3.5.

Për çdo grup studentësh (të përcaktuar me statutin e institucionit) dhe për çdo 60 kredi ECTS në programin e studimit, institucioni ka punësuar të paktën një punonjës me orar të plotë me titull doktorature ose titull të njëjtë në rastin e institucioneve shkencore artistike/aplikative.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Për çdo grup studentësh të përcaktuar sipas IAL dhe për çdo 60 kredi ECTS në programin e studimit, Fakulteti Ekonomik ka punësuar një profesor me orar të plotë me marrëdhënie të rregullt pune me titull doktor (PhD) nga fusha e programit të studimeve, sipas nenit 26, pika 5.3.4 dhe pika 5.3.5 Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë Republikën e Kosovës, të dates 28.09.2018 dhe atë:

1. Prof.Ass.Dr.Lutfi Zharku , bartës i programit - fusha financë
2. Prof.Ass.Dr.Arben Mustafa, bartës i programit - fusha ekonomiks
3. Dr. Arben Sahiti , bartës i programit - fusha banka, financë dhe kontabilitet

Standardi 3.6.

Janë ofruar mundësi për zhvillim profesional shtesë të stafit mësimdhënës, me ndihmën e veçantë që u jepet çdo personi që has vështirësi.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

UKZ vitet e fundit ka filluar me një ndihmë solide për stafin që ta mbështesë me pjesëmarrje në nëpër konferenca dhe aktivitete të ndryshme shkencore të cilat ndikojnë në për mirësimin e nivelit të përgjithshëm profesional dhe akademik. Një aspekt tjetër është ai i përfshirjes së UKZ nëpër projekte të ndryshme të ndryshme si ERASMUS + të cilat kanë ndihmuar në avancimin e nivelit të stafit.

Edhe [Marrëveshja me UP dhe Qendrën për Përsosmëri në Mësimdhënie](#) mundëson zhvillimin e stafit akademik të UKZ, duke marrë pjesë në trajnime në të gjitha fushat respektive, duke ofruar një qasje të re dhe numër të konsidereshëm të programeve të trajnimit. Kjo bëhet me qëllim që stafi i UKZ-së të jetë vazhdimisht në rrjedhat më bashkëkohore të procesit të mësimdhënies.

UKZ mundëson trajnime për stafin akademik në metodologji të mësimdhënies (QPM), pastaj në vlerësim sumativ dhe formativ nëpërmjet projektit me GIZ, trajnime për përfshirjen e teknologjisë në mësimdhënie, trajnime për stafin administrativ nëpërmjet IKAP etj.

Megjithkëtë, nevoja për përmirësim është permanente dhe në këtë drejtim kërkohet mbështje edhe më e madhe.

Nevojat konsistojnë në pjesëmarrje më të madhe në konferenca, seminare shkencore dhe trajnime. Po ashtu për zhvillim profesional stafi i FE ka nevojë për ngritje të nivelit të njohjes së gjuhëve të huaja.

Tabela 13:Pjesmarrja e stafit ne trajnime

Titulli i projektit	Vendi	Viti	Pjesëmarrësit
ERASMUS+ project Entrepreneurial Universities for Industry Alliances – EUFORIA; WORKSHOP.	Ferizaj Kosovo	2017	Xhevat Sopi Nexhat Shkodra Arben Sahiti
Trajnimi i stafit akademik në Nottingham, UK (Nottingham Trent University) me temë “CURRICULUM DEVELOPMENT WORKSHOP”.	Nottingham, UK	2018	Xhevat Sopi Naim Mustafa
Qendra për përsosshmëri në mësimdhënie e Universitetit të Prishtinës WORKSHOP: -Vlerësimin dhe standardet e vlerësimit ne institucionet e arsimit te larte	Prishtinë, Kosovo	2016	Xhevat Sopi Arbenita Kosumi
Qendra për përsosshmëri në mësimdhënie e Universitetit të Prishtinës Workshop: Mesimi aktiv ne arsimin e larte	Prishtinë, Kosovo	2016	Xhevat Sopi Arbenita Kosumi
MINISTRIA E ARSIMIT PËR SHKENCË DHE ZHVILLIM TEKNOLOGJIK,BEOGRAD,RR.NEMANJINA 22-26, LICENC PËR AFTËSIM NË ARSIM, Aftësim profesional në metodat dhe teknikat e vlerësimit në arsim Nr.291/1-2016	Bujanoc	2017	Shefket Jakupi
INSTITUTI PËR PROMOVIMIN E ARËSIMIT DHE EDUKIMIT TË TRAJNIMIT Nr.570-434/2016 të datës 18.04.2016 - FLETËT E PUNËS, KRIJIMI SIPAS RRJEDHËS SË ORËS NËSIMORE Nr.10579/2016	Bujanoc	2017	Shefket Jakupi
MINISTRIA E ARSIMIT PËR SHKENCË DHE ZHVILLIM TEKNOLOGJIK,BEOGRAD,RR.NEMANJINA 22-26, LICENC PËR AFTËSIM NË ARSIM, viti 2013, Licenca, Nr.152-00-330/2010-2013	Preshevë	2013	Shefket Jakupi
BASHKIMI I MËSIMËDHËNËSVE, ”BET FORUM”UZHICË,CERTIFIKATA Nr.05633,2013	Bujanoc	2013	Shefket Jakupi
AKTIVITETET THEMELORE - ARSIMIT TË ORIENTUAR,16 orë trajnime, ENTI PËR AVANSIM NË SHKENCË DHE ARSIM,Nr.860-632/2012 të datës 09.05.2012	Bujanoc	2012	Shefket Jakupi

BASHKIMI I MËSIMËDHËNËSVE,"BET FORUM" UZHICË, CERTIFIKATA Nr.05660,viti 2012, METODAT AKTIVE - ARSIMIT TË ORIENTUAR, 16 orë trajnimi,ENTI PËR AVANSIM NË SHKENCË DHE ARSIM,Nr.860-632/2012 të datës 09.05.2012	Bujanoc	2012	Shefket Jakupi
BASHKIMI I MËSIMËDHËNËSVE,"BET FORUM"UZHICË, CERTIFIKATA Nr.05688,viti 2012, PLANIFIKIMI AKTIV-ARSIMIT TË ORIENTUAR,16 orë trajnimi, ENTI PËR AVANSIM NË SHKENCË DHE ARSIM,Nr.860-632/2012 të datës 09.05.2012	Bujanoc	2012	Shefket Jakupi
TË ARRITURIT E TË RINJËVE NË SERBI,SOKO BANJË, CERTIFIKAT për ndjekjen e programit - AFTËSIM PROFESIONAL, Nr.120-09/10,viti 2009,TË ARRITURIT E TË RINJËVE, 36 orë trajnimi, Program shkollor 2009/2010 nr.842	Bujanoc	2012	Shefket Jakupi
AKTIVITETET THEMELORE - ARSIMIT TË ORIENTUAR,16 orë trajnimi, ENTI PËR AVANSIM NË SHKENCË DHE ARSIM,Nr.860-632/2012 të datës 09.05.2012	Bujanoc	2012	Shefket Jakupi
Programet: Certifikat nga MFS Ekspert i fushës "Zbatimi i Ekonomisë", "Program për kompani" "MESE program"	Bujanoc	2012	Shefket Jakupi
LECU – Learning Cultures in Universities	Switzerland, Albania, Kosova	2018 - 2020	1. Teuta Agaj Avdiu 2. Shpresë Qamili
Teaching methodologies	Prishtinë, Kosovo	2015	Teuta Agaj Avdiu
Learner Autonomy in Higher Education	Tetovo	2013	Teuta Agaj Avdiu
The role of students in the University of Prishtina and Albanian society	Prishtinë, Kosovo	2010	Teuta Agaj Avdiu
Program for Change and Leadership	Prishtinë, Kosovo	2010	Teuta Agaj Avdiu
Education for Peace and Tolerance	Prishtinë, Kosovo	2009	Teuta Agaj Avdiu
"Si të shkruajmë një projekte të suksesshëm në kuader të programit Erasmus+"	Prishtinë, Kosovo	2019	Lulzim Rashiti
ERASMUS+ project Entrepreneurial Universities for Industry Alliances – EUFORIA; Training: "Placement Officer"	Staffordshire University UK	2016	Lulzim Rashiti

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore Organizuar nga: BM Consulting	Prishtinë, Kosovo	2013	Lulzim Rashiti
European Foundation Certificate of Banking (EFCB) Organizuar nga: Shoqata e banakve te Kosoves	Prishtinë, Kosovo	2013	Lulzim Rashiti
CERGE-EI Teaching Development Program: Co-Teaching and Collaborative Principles and Practices	Prishtinë, Kosovo	2019	Arben Mustafa Gëzim Tosuni
Trajnimi i stafit akademik në Ancona, Italy (Universita Politecnico dele Marche) me temë “Workshop on Case study development”.	Ancona, Italy	2017	Arben Mustafa Gëzim Tosuni
Career Integration Fellows Teaching Principles and Practices for Economics Course	Prague, Czech Republic	2017	Arben Mustafa
ERASMUS+ project Entrepreneurial Universities for Industry Alliances – EUFORIA; Workshop: Case Study Development	Nottingham, UK	2017	1.Arben Sahiti 2.Gezim Tosuni
SPSS Workshop, University “ Kadri Zeka” Gjilan	Gjilan Kosovo	2018	Arben Sahiti
Logistics Training Course	Iraq	2007	Arben Sahiti
Container Management Training Course	Iraq	2007	Arben Sahiti
Material Requisition Training Course	Iraq	2007	Arben Sahiti
Property 101 Training Course	Iraq	2007	Arben Sahiti

Standardi 3.7.

Përgjegjësitë e të gjithë stafit mësimdhënës, sidomos me kohë të plotë, përfshijnë angazhimin në komunitetin akademik, disponueshmërinë për konsultime me studentët dhe shërbimin e komunitetit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Personeli akademik është përgjegjës për mësimdhënien dhe mësimin, duke përfshirë punën kërkimore shkencore, angazhimin për konsultime studentore dhe përgjegjësitë e tjera që lidhen me kontratën e tij / saj.

Angazhimet e stafit të rregullt akademik rregullohen nga politika e UKZ dhe njërive akademike si ne vijim:

- Nga 2-6 orë në javë, është e obligueshme që të mbahen konsultime me studentin
- Vlerësimi i Studentëve
- Mentorimi i diplomës së studentit
- Aktivitetet kërkimore
- Pjesëmarrje në debatet tryezat dhe diskutime të ndryshe profesioanle e shkencore
- Pjesëmarrje në takime me Brodin Industrial
- Pjesëmarrje në takime e debate të organziauar nga shoqëria civile dhe komunitat

Standardi 3.8.

Vlerësimi i stafit akademik kryhet rregullisht të paktën një herë në vit përmes vlerësimit të studentëve , dhe eprorëve dhe bëhet në baza zyrtare . Rezultatet e vlerësimit janë publike.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Vlerësimi i stafit akademik nga ana e studentëve realizohet në dy faza. Faza e parë do të përfshijë vlerësimin pas përfundimit të semestrit dimëror si dhe faza e dytë do të përfshijë vlerësimin pas përfundimit të semestrit veror. ZZhAC, publikon rezultatet e hulumtimit në këtë mënyrë: Secilit mësimdhënës të vlerësuar i dërgohen rezultatet e tij në mënyrë elektronike, studentët marrin informacion rreth vlerësimit përmes raporteve të shprehura gojarisht nga dekani dhe mësimdhënësit, Dekanët dhe Prodekanët marrin të gjitha rezultatet për fakultetin e tyre, kurse Rektori dhe Prorektorët marrin të gjitha rezultatet për Universitetin. [Raporti përmbledhës 1](#) dhe [2](#) publikohet në ëeb faqen e Universitetit.

Mekanizëm tjetër për vlerësimin e cilësisë nëpër NJA të UKZ-së, aplikohet edhe vlerësimi nga Menaxhmenti i Fakultetit për stafin akademik.

Ne rastete e vlerësimeve jo te kënaqshme, konform [Rregullores për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit në UKZ](#) merren veprime adekuate për tu tejkaluar vështirësitë dhe për tu përmirësuar niveli akademik i mësimdhënësit

Standardi 3.9.

Strategjitë për përmirësimin e cilësisë përfshijnë përmirësimin e strategjive të mësimdhënies dhe cilësinë e materialeve mësimore.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

- Strategjitë për përmirësimin e cilësisë janë në harmoni me strategjinë e planifikimit zhvillimore FE dhe UKZ.
- Kjo konsiston ngritjes profesionale dhe akademike të stafit akademik, infrastrukturës mësimore dhe përgatitjes së materialeve mësimore conform programit studimor dhe zhvillimet të reja në fushën e studimit.
- Përfshirjen e ekspertëve nga industria në procesin e mësidhënies përmes ligjëratave të tipit guest speaker por edhe bashkëpunimin për ngritjen e komponentës së trajnimeve nga pjesa praktike.

Standardi 3.10.

Mësimdhënësit pensionohen në kufijtë e moshës ose për arsye të tjera humbasin statusin e mësimdhënësve me orar të plotë dhe konsiderohen mësues me kohë të pjesshme.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Mësimdhënësit konform ligjit pensionohen në moshën 65 vjet. Më tutje ata mund të vazhdojnë punën part-time deri në moshën 70 vjecare. Për ndryshe statusi i mësimdhënësit mund të ndryshojë konform ligjit dhe kontratës së punës.

Tabela 14: Analiza SWOT për stafin akademik:

A. Pikat e forta	B. Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Lendet e programeve te studimit ligjerohen nga stafi akademik me kualifikime relevante akademike dhe profesionale (thirrje akademike dhe grada shkencore), të parapara sipas sipas Ligjit Arsimit të Lartë dhe Udhëzimit Administrativ. • Profesoret janë te ngarkuar me lende te cilat perkojne me fushat e tyre te studimit. • Stafi akademik ka përvojë të mjaftueshme shkencore dhe praktike. • Një numër i tyre vjen nga industria dhe kanë përvojë të mjaftueshme menaxheriale. 	<ul style="list-style-type: none"> • Institucioni nuk ka buxhet të mjaftueshëm për ndihmesë profesorëve për publikime shkencore në revista me recenzime ndërkombëtare dhe impact faktor, këtë profesorët e realizojnë me mjete vetanake. • Një numër i personelit akademik nuk njohin mjaftueshëm gjuhën angleze apo ndonjë gjuhë tjetër, për shfrytëzimin e literaturës më të avancuar shkencore.
C. Mundësitë	D. Sfidat
<ul style="list-style-type: none"> • Personelit akademik i kërkohet dhe i mundësohet që të bëjnë kërkime shkencore dhe publikim te rezultateve ne revista dhe konferenca shkencore. • Bashkepunim më i madhe me bizneset është mundësi shtesë e stafit akademik për të realizuar kërkime shkencore që zgjidhin probleme praktike. • Bashkepunim me bizneset te aplikojnë te arriturat me te reja te teknologjisë ne procesin e mësimdhënies.. 	<ul style="list-style-type: none"> • Domosdoshmëri e ngritjes profesionale dhe akademike të stafit, ndjekjes së konferencave shkencore dhe publikimeve në revistat prestigjioze me recensione ndërkombëtar pa marrë parasysh gjendjen financiare të FE dhe profesorëve. • Domosdoshërisht përcjellja e teknologjisë moderne për realizimin e orës mësimore si dhe përcjellje e risive nga fusha e studimit.

2.4 Përmbajtja e procesit arsimor

Standardi 4.1.

Programi i studimit është modeluar në objektivat e kualifikimit. Këto përfshijnë aspekte të lidhura me lëndët dhe ndërdisiplinore si dhe përvetësimin e shkathtësive dhe kompetencave disiplinore, metodologjike dhe gjenerike. Aspektet i referohen sidomos kompetencave akademike ose artistike, aftësisë për të marrë punësim adekuat, duke kontribuar në shoqërinë civile dhe zhvillimin e personalitetit të studentëve.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Programi Financë dhe Kontabilitet i aplikuar ofron mundësi studimore duke u mbështetur në kurikulat bashkëkohore, më të arriturat shkencore dhe kërkimet që realizohen në Financë dhe Kontabilitet i aplikuar.

Programi i studimit është i krahasueshëm dhe i harmonizuar me studimet bachelor të këtyre Universiteteve :

Universiteti i Lubljanës

http://www.ef.uni-lj.si/content/static_english/izobrazevanje/dodiplomsko/upes.asp

Universiteti i Splitit

<http://www.efst.unist.hr/studiranje/za-studente/studijski-program/preddiplomski-studiji/pe>

Universiteti i Zagrebit

<https://www.efzg.unizg.hr/en>

Standardi 4.2.

Programi i studimit është në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet e Zonës Europiane të Arsimit të Lartë. Komponentët individualë të programit kombinohen në një mënyrë që të arrijnë më së miri objektivat e specifikuar të kualifikimit dhe ofrojnë forma adekuate të mësimdhënies dhe të mësuarit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Programi bachelor Financë dhe Kontabilitet i aplikuar është program i bazuar në kurikulat kombëtare të mbështetura në Kornizën për Kualifikimet e Zonës Europiane të Arsimit të Lartë. Një program i tillë është poashtu në përputhshmëri me nevojat e tregut vendor dhe jashtëm, për arsye se është kompatibil me programet mësimore nga fusha e finaces dhe kontabilitetit që zhvillohen në vendet respektive. (shih me sipër linqet e universiteteve krahasuese).

Standardi 4.3.

Disiplinat brenda kurrikulit sigurohen në një rrjedhë logjike dhe plotësojnë përkufizimin dhe përcaktimin e saktë të kompetencave të përgjithshme dhe specifike, si dhe pajtueshmërinë me programet e studimit dhe kurikulat e dorëzuara në ZEAL. Duhet të listohen të paktën 7 rezultatet të të nxëniet për programin e studimit nën vlerësim.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Plani i studimeve është i ndërtuar në atë mënyrë që të jetë në gjendje t'iu përgjigjet sfidave të ndryshme afatshkurtra dhe afatgjatë brenda një organizate.

Rezultatet e të nxëniet

Pas përfundimit të programit të studimit në financë dhe kontabilitet të aplikuar studentët do të:

1. Fitojnë njohuri për konceptet e përgjithshme teorike ekonomike dhe në mënyrë specifike nga fusha e financës dhe kontabilitetit
2. Fitojnë njohuri për institucionet dhe tregjet financiare si dhe instrumentet politikave fiskale dhe monetare.
3. Njihen me metodat dhe teknikat bashkëkohore nga fusha e e financës, kontabilitetit
4. Jenë në gjendje të shfrytëzojnë teknologjinë bashkëkohore informative (softuerë përkatës) për kryerje të detyrave komplekse;
5. Jenë në gjendje që si kontabilistë dhe financierë të aftë të përmbushin kërkesat e tregut si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.

6. *Fitojnë njohuri në fushën e kontabilitetit për sa i përket ndërtimit, paraqitjes së elementëve të pasqyrave financiare duke njohur dhe zbatuar Standardet Kombëtare të kontabilitetit (SKK), Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimeve Financiare (SNRF);*
7. *Jenë të aftë të krijojnë dhe të menaxhojnë në mënyrë efikase asetet e tyre financiare në tregun financiar dhe se si t'i menaxhojnë rreziqet e ndryshme;*
8. *Të fitojë aftësi të nevojshme të punës në ekip për zgjidhjen e problemeve.*
9. *Demonstrojnë aftësi analitike dhe prezantuese, dhe të japin këshilla të specializuara teknike, për profesionistët dhe jo-ekspertë të përfshirë në industrinë e shërbimeve financiare.*
10. *Fitojnë kompetenca të nevojshme të të menduarit kritik dhe shkencore që u mundësojnë të realizojnë hulumtime dhe të vazhdojë tutje studimet në nivelin master(MSc).*

Standardi 4.4.

Disiplinat brenda kurrikulës kanë syllabusë analitike të cilët përfshijnë të paktën: objektivat e disiplinës, përmbajtja themelore tematike, rezultatet e të nxënës, shpërndarja e klasave, seminarët dhe aktivitetet aplikative, sistemi i vlerësimit të studentëve, bibliografia minimale, etj. Përshkrimet e plota të lëndëve/ syllabusët për secilën lëndë duhet të bashkëngjiten vetëm në formë elektronike raportit të vet vlerësimit për programin e studimit nën vlerësim.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Disiplinat brenda kurrikulës kanë syllabusë analitike të cilët përfshijnë të paktën: objektivat e disiplinës, përmbajtja themelore tematike, rezultatet e të nxënës, shpërndarja e klasave, seminarët dhe aktivitetet aplikative, sistemi i vlerësimit të studentëve, bibliografia minimale, etj.

Standardi 4.5.

Nëse gjuha e mësimdhënies është e ndryshme nga ajo Shqipe, merren masa për të siguruar që aftësitë gjuhësore të të dy studentëve dhe stafit akademik janë adekuate për mësimin në atë gjuhë kur studentët fillojnë studimet e tyre. Kjo mund të bëhet përmes trajnimeve gjuhësore para fillimit të programit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe. Nëse ka interesim të studentëve për zhvillimin e mësimin edhe në gjuhët tjera zyrtare, FE ka mundësi dhe staf akademik për zhvillimin e mësimin edhe në gjuhë tjera zyrtare të Republikës së Kosovës. Gjithashtu nese ka raste qe ne kuader te mobilitetit te Erasmus + te kete ndonje student qe vjen ne FE, stafi i cili njih rrjedhshem gjuhen angleze jane te gatshem qe te kontribojne ne kete aspekt.

Standardi 4.6.

Marrëdhënia student-mësues është një partneritet në të cilin secili merr përgjegjësinë e arritjes së rezultateve të mësimin. Rezultatet e mësimin shpjegohet dhe diskutohen me studentët nga këndvështrimi i rëndësisë së tyre në zhvillimin e studentëve.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Raportet student-profesor janë raporte bashkëpunimi ku profesori i ofronë mundësinë e mjaftueshme studentit për vetëstudim dhe vetë përparim duke pasur çdo herë kontrollin e mjaftueshëm ndaj punës së studentit. Këto raporte zhvillohen pastaj edhe në fushën e hulumtimit që shpeshherë janë të përbashkëta në arritjen e rezultateve të mësimin.

Varësisht nga rëndësia studimit hulumtimet bëhen në formë individuale dhe grupe duke mos cenuar asnjëher rezultatet e arritura gjatë hulumtimit.

Standardi 4.7.

Strategjitë e mësimdhënies janë të përshtatshme për llojet e ndryshme të programeve të rezultateve të të mësuarit që synojnë të zhvillohen. Strategjitë e mësimdhënies dhe vlerësimit të përcaktuara në specifikimet e programeve dhe kurseve janë ndjekur me fleksibilitet për të plotësuar nevojat e grupeve të ndryshme të studentëve.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Strategjitë e mësimdhënies janë përshtatur me specifikat e programit, me kurset e përshtatshme për të plotësuar nevojat e tregut të punës në Kosovë dhe jashtë.

Bazuar në [Udhëzuesin për përdorimin e ECTS-ve](#), mësimi me studentët në qendër është një proces i transformimit cilësor të njohurive dhe shkathtësive për studentë dhe individë të tjerë në një mjedis të nxënies-studjuarrit, që synon përmirësimin, autonominë e tyre dhe zhvillimin e aftësive kritike përmes një qasje të bazuar në rezultate.

Koncepti *studenti në qendër*, mund të përmbledhet në elementët:

- mbështetja në mësimin aktiv dhe jo në mwsimin pasiv;
- nxitja e mendimit kritik dhe analitik;
- rritje e përgjegjësisë nga ana e studentëve;
- rritja e autonomisë së studentëve.

Për këtë qëllim, Syllabuset për secilën lëndë dhe për secilin program studimi, publikohen në uebfaqe dhe u shpërndahen studentëve në fillim të semestrit.

Vlerësimi i studentëve bëhet gjat gjithë semestrit. Studenti motivohet për të qenë aktiv dhe ky motivim rezulton në mësim cilësor, kritik dhe analitik. Në syllabuset e lëndëve potencohet përdorimi i metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies, si: interaktiviteti, nxitja e mendimit kritik, ofrimi i kushteve për të mësuar në bibliotekë, përdorimi i TI, puna në grupe, puna në projekte, klubet e studenteve, puna kreative etj.

Ligjëratat dhe ushtrimet e studentëve janë të orientuara në punën në grupe: studentët punojnë të pavarur në grupe, diskutojnë dhe nxjerrin përfundime të përbashkëta. Studentët punojnë në grupe edhe në detyra shtëpie, në seminare, në prezantime, në projekte si edhe në tema të diplomës.

Në tërë këtë proces, përdorimi i [Moodle, e-learning](#) bënë të mundur dhe të jetë më efikas realizimi i mësimdhënies me studentin në qendër.

Standardi 4.8.


Mekanizmat e vlerësimit të nxënësve zhvillohen në mënyrë të drejtë dhe objektive, janë të përshtatshme për format e ndryshme të të mësuarit të kërkuar dhe u komunikohen qartë studentëve në fillim të kurseve.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Përmes syllabueseve të lëndëve parashihen dhe format e vlerësimit lidhur me arritje të studentit. Ato konsistojnë në ndarjen proporcionale të kohës së mësimit dhe hulumtimit. Që në fillim studenti e ka të qartë angazhimin e tij dhe format të cilat duhet zbatuar për një vlerësim pozitiv. Ato konsistojnë në angazhimin e studentit në ligjërata, ushtrime, konsultime, hulumtime, punim projekti etj. Pra kryesisht dominon qasja e vlerësimit formativ. Rezultatet e vlerësimit shpallen në llogarinë e SMU ose në web, dhe për secilin prej tyre caktohen konsultimet ku studentet kanë mundësi me i pa testet/punën e tyre.

Me qëllim të ngritjes së disiplinës për respektimin e rregullave të vlerësimit dhe transparencës në vlerësim, këshilli i Fakultetit Ekonomik ka miratuar edhe një [udhëzues për kriteret e vlerësimit](#) i cili i është dhënë të gjithë stafit, studentëve përmes Parlamentit të Studenve dhe është publikuar në faqen e mëposhtme.

Me vazhdim të shpjegimit të rezultateve të provimit:

	FAKULTETI EKONOMIK Rezultatet nga Analiza e të Dhenave për Hulumtime në Biznes Mbajtur me 11.05.2019 Prof.Ass.Dr.Xhevat Sopi; Konsultimet mbahen të henen, me 20.05.2019 ora 13:30!						
Nr	ID	Aktivitet & pjesëmarrje	Detyra	Provim praktik	Provim teorik	Total	Nota
1	xxxxxxx	5	15	19	38	77	8
2	xxxxxxx	4	12	23	32	71	8

Standardi 4.9.

Mekanizmat e përshtatshëm, të vlefshëm dhe të besueshëm përdoren për të verifikuar standardet e arritjeve të studentëve. Standardi i punës i kërkuar për nota të ndryshme është konsistent me kalimin e kohës, i krahasueshëm në kurset e ofruara brenda një programi dhe në krahasim me programet e tjera të studimit në institucionet e vlerësuara.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Qasja e vlerësimit përgjithësisht në UKZ, rrjedhimisht edhe në Fakultetin Ekonomik, është ajo e vlerësimit formativ. Këshilli i Fakultetit ka dhënë udhëzime dhe rekomandime për profesorët që të ketë një parim të përgjithshëm formativ për vlerësimin e studentit sipas Procesit të Bolonjës, prandaj duke mbajtur parasysh këto parime, me siguri të të rëndësishme mund të konkludohet se standardet e punës që kërkojnë për nota të ndryshme nuk kanë variacione të mëdha me kalimin e kohës por janë konsistente dhe të ngjashme për kurset e ndryshme brenda programave.

Standardi 4.10.

Politikat dhe procedurat përfshijnë veprimet që duhen ndërmarrë për të trajtuar situatat ku standardet e arritjeve të studentëve janë të pamjaftueshme ose vlerësohen në mënyrë jokonsistente.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Ne rastet kur nuk janë permbush standardet e arritjeve të studentëve, kur ato janë të pamjaftueshme ose vlerësohen në mënyrë jokonsistente, atëherë reagohej përmes keshillit të fakulltetit ku ndërrmerren masa si:

- Trajtim i rastit së bashku me mesimdhënesin për të parë se ku qëndron problemi
- Organizimi i orëve shtesë
- Ndërrimi i metodave të mesimdhënesit
- Analiza e materialit konkretizues si: literatura dhe pajisjet laboratorike

Standardi 4.11.

Nëse programi i studimit përfshin fazë praktike, rezultatet e pritshme të mësimit të studentëve janë të specifikuar qartë dhe proceset efektive ndiqen për të siguruar që rezultatet e mësimit dhe strategjitë për të zhvilluar atë mësime janë kuptuar nga studentët. Fazat e praktikës janë ndarë kredi ECTS dhe puna e studentëve në organizatat e trajnimit praktikë monitorohet përmes raporteve të aktiviteteve; studentët gjatë fazave të praktikës kanë caktuar mësues nga personeli akademik në programin e studimit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

UKZ ka themeluar Placement Office si dhe ka emëruar koordinatoren për bashkëpunim me biznese të cilin organizon në mënyrë të rregullt realizimin e mësimit praktik të studentëve në biznese dhe institucione qeveritare dhe joqeveritare. Në këtë kuadër është e rregulluar edhe edhe aspekti i vlerësimit të studentëve përmes raporteve nga mikëqyrsit, si të fakulteteve ashtu edhe të përgjegjësve nga organizatat.

Standardi 4.12.

Për të lehtësuar fazat e praktikës, institucioni i arsimit të lartë nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi, kontrata ose dokumente të tjera me institucionet/organizatat/njësitë e trajnimit praktikë.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Institucioni i arsimit të lartë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, kontrata ose dokumente të tjera me institucionet publike, bizneset private, bankat, agjencitë për shërbime të kontabilitetit, Administratën tatimore, etj.

Tabela 15: Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit arsimor:

Pikat e forta	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none">• Mesimdhënes të dëshmuar dhe të vlerësuar pozitivisht nga studentët në anketimet e vazhdueshme (për çdo semestër të organizuar nga Zyra për Zhvillim Akademik)• Ekzistenca e imazhit pozitiv përballë institucioneve arsimore publike dhe private;	<ul style="list-style-type: none">• Aktivitete të pamjaftueshme shkencore e hulumtuese.• Adaptimi jo i shpejtë i stafit akademik me risi.

<ul style="list-style-type: none"> • Cilësia e lartë e kurrikulave të ofruara për programin e studimit bazuar në programet relevante krahasuese. • Cilësia e syllabuseve të përshtatur ne funksion te realizimit te objektivave te programit, sipas standardeve bashkekohore bazuar në programet relevante krahasuese. • Përdorimi i teknologjisë moderne (projektorë, software etj.) në procesin e mësimdhënies; • Interaktiviteti; • Puna praktike; • Notimi përmes aktiviteteve gjatë semestrit; • Procesi i përzgjedhjes për regjistrimin e studentëve. 	
<p>Mundësitë</p>	<p>Sfidat</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunimet ndërkombëtare dhe sjellja e profesorëve vizitore nga jashtë universitetit; • Angazhimi i stafit nga industria ne cilësinë e guest speakers apo edhe mbajtjes se nje pjese te ushtrimeve • Angazhimet e studenteve ne projekte kerkimore përmes industrisë • Shfrytëzimi i burimeve elektronike-online per thellimin ne studime te caktuara dhe përvetësim te teknikave te reja 	<ul style="list-style-type: none"> • Numër i limituar i studentëve (raport regresiv mes natalitetit dhe raport progresiv i emigracionit) • Norma e punësimit respektivisht mungesa e zhvillimit ekonomik zvogelon gjasat e investimeve progresive. • Konkurenca e brendshme dhe e jashtme.

2.4.1 Pasqyra e lëndëve për programin: Financë dhe Kontabilitet i aplikuar (BSc)

- Këshilli i Fakultetit Ekonomik (KFE) ka aprovuar planin mësimor për programin Financë dhe Kontabilitet i aplikuar me përzgjedhje të moduleve konform programit të miratuar.
- Numri i lëndëve në total sipas shpërndarjes në semestër, për programin Financë dhe Kontabilitet i aplikuar për vitin akademik 2021-25, janë të paraqitura sipas tabelave në vijim të specifikuara sipas moduleve dhe kurrikulave.
- Studentët orientimisht që nga viti i dytë përcaktohen për njërin nga dy grupet e moduleve, kurse përfundimisht përcaktohen kur të regjistrojnë vitin e tretë.
- Zgjedhja e grupeve të moduleve (koncentrimet) do të jetë proporcionale

Tabela 16: Tabela me informatat për vitin I; semestri I

Viti I						
Semestri I			Orë/javë			Mësimdhënësi
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	
1.	O	Mikroekonomi	3	2	7	Ass.Dr.sc. Nexhat Shkodra
2.	O	Matematika për ekonomistë	3	2	7	Prof.Asoc.Dr.Musa Ajeti
3.	O	Parimet e Kontabilitet	3	2	7	Ass.Dr.sc. Arben Sahiti
4.	O	E drejta biznesore	2	1	5	Prof.Ass.Dr.Liridon Dalipi
5.	O	Shkrim Akademik	2	2	5	Prof.Asoc.Dr.Nevrije Isamjli
Total (30 ECTS x 25 orë = 750)					30	

Shkurtesat: O – Obligative; Z – Zgjedhore; L – Ligjerata; U–Ushtrime; ECTS – kredit

Tabela 17: Tabela me informatat për vitin I; semestri II

Viti I						
Semestri II			Orë/javë			Mësimdhënësi
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	EC TS	
1	O	Makroekonomi	3	2	7	Ass.Dr.sc. Nexhat Shkodra
2	O	Bazat e Statistikës	3	2	7	Prof.Ass.Dr.Xhevat Sopi
3	O	Bazat e Menaxhmentit	2	1	6	Prof.Asoc.Dr.Naim Mustafa
4	O	Anglishtja për biznes I	2	2	5	Prof.Ass.Dr.Teuta Agaj-Avdiu
5	Z	Integrimet ekonomike në BE	2	1	5	Prof.Ass.Dr.Lutfi Zharku
6	Z	Matematikë Financiare	2	2	5	Prof.Asoc.Dr.Musa Ajeti
Total (30 ECTS x25orë = 750)					30	

Shkurtesat: O – Obligative; Z – Zgjedhore; L – Ligjerata; U–Ushtrime; ECTS – kredit

Tabela 18:Tabela me informatat për vitin II; semestri III

Viti II						
Semestri III			Orë/javë			Mësimdhënësi
N r.	O/Z	Lëndët	L	U	EC TS	
1	O	Financa	2	1	6	Prof.Ass.Dr.Lutfi Zharku
2	O	Sistem tatimor	2	1	6	Ass.Dr.sc. Nexhat Shkodra
3	O	Analizë statistikore financiare	2	2	6	Prof.Ass.Dr.Xhevat Sopi
4	O	Bazat e kontabilitetit financiar	2	2	7	Prof.Dr. Skender Ahmeti
4	Z	Marketing	2	1	5	Dr.sc. Art Shala
6	Z	Makroekonomi II	2	1	5	Prof.Ass.Dr.Arben Mustafa
7	Z	Anglishtja per biznes II	2	2	5	Prof.Ass.Dr.Teuta Agaj-Avdiu
Total (30 ECTS x 25 orë = 750)					30	

Shkurtesat: O – Obligative; Z – Zgjedhore; L – Ligjerata; U–Ushtrime; ECTS – kredit

Udhëzim: Tek lëndët zgjedhore për vitin e dytë, semestri i III-të, studenti zgjedh një nga lëndët zgjedhore.

Tabela 19: Tabela me informatat për vitin II; semestri IV

Viti II						
Semestri IV			Orë/javë			Mësimdhënësi
N r.	O /Z	Lëndët	L	U	ECTS	
1	O	Financat Nderkombetare	2	1	6	Prof.Ass.Dr.Lutfi Zharku
2	O	Financat e Koorporatave	2	1	6	Prof.Ass.Dr.Arben Mustafa
3	O	Bazat e Kontabilitetit Menaxherial	2	2	7	Prof.Ass.Dr. Shefket Jakupi
4	O	Tregjet dhe Institucionet Financiare	2	1	6	Prof.Ass.Dr. Gezim Tosuni
4	Z	Ekonomiksi Monetar	2	1	5	Ass.Dr.sc. Arben Sahiti
5	Z	Ekonomia e Kosovës dhe Zhvillimi	2	1	5	Ass.Dr.sc. Nexhat Shkodra
6	Z	Ekonomiksi i sektorit publik	2	1	5	Prof.Ass.Dr.Refik Kryeziu
Total (30 ECTS x 25 orë = 750)					30	

Shkurtesat: O – Obligative; Z – Zgjedhore; L – Ligjerata; U–Ushtrime; ECTS – kredit

Udhëzim: Tek lëndët zgjedhore për vitin e dytë, semestri i IV-të, studenti zgjedh një nga lëndët zgjedhore.

Tabela 20: Tabela me informatat për vitin III; semestri V

Viti III						
Semestri V			Orë/javë			Mësimdhënësi
N r.	O /Z	Lëndët	L	U	ECTS	
1	O	Raportimi financiar dhe SNRF	2	2	6	Prof.Ass.Dr. Shefket Jakupi
2	O	Afarizëm Bankar	2	1	6	Prof.Ass.Dr.Arben Mustafa
Module me zgjedhje Financë (F)						
3	Z	Qeverisja Koorporative	2	1	6	Prof.Ass.Dr. Gezim Tosuni
4	Z	Sistemi monetar evropian	2	1	6	Prof.Ass.Dr.Lutfi Zharku
5	Z	Financat Publike	2	1	6	Ass.Dr.sc. Nexhat Shkodra
6	Z	Biznes Nderkombetar	2	1	6	Prof.Ass.Dr. Bajram Fejzullahu
Module me zgjedhje Kontabilitet i Aplikuar (KA)						
7	Z	Softvere kontabiliteti	2	2	6	Prof.Ass.Dr. Shefket Jakupi
8	Z	Analiza e Pasqyrave financiare	2	2	6	Prof.Ass.Dr.Lutfi Zharku
9	Z	Kontabiliteti Financiar	2	2	6	Prof.Dr. Skender Ahmeti
10	Z	Kontabiliteti Menaxherial	2	2	6	Ass.Dr.sc. Arben Sahiti
Total (30 ECTS x 25 orë = 750)					30	

Shkurtesat: O – Obligative; Z – Zgjedhore; L – Ligjerata; U–Ushtrime; ECTS – kredit

Udhëzim: Tek lëndët zgjedhore për vitin e tretë, semestri i V-të, nga moduli përkatës studenti zgjedh tri nga lëndët zgjedhore.

Tabela 21: Tabela me informatat për vitin III; semestri VI

Viti III						
Semestri VI			Orë/javë			Mësimdhënësi
N r.	O /Z	Lëndët	L	U	ECTS	
1	O	Auditimi dhe sistemi i kontollit	2	1	6	Prof.Ass.Dr. Shefket Jakupi
2	O	Menaxhimi Financiar	2	1	6	Ass.Dr.sc. Arben Sahiti
Module me zgjedhje Financë (F)						
3	Z	Menaxhimi i bankar	2	1	6	Prof.Ass.Dr.Refik Kryeziu
4	Z	Menaxhimi i riskut dhe sigurime	2	1	6	Prof.Ass.Dr. Gezim Tosuni
5	Z	Analize e Investimeve	2	1	6	Prof.Ass.Dr.Arben Mustafa
Module me zgjedhje Kontabilitet i Aplikuar (KA)						
6	Z	Aplikime kontabiliteti me softver	3	2	6	Prof.Ass.Dr. Shefket Jakupi
7	Z	Kontabiliteti Publik	2	2	6	Ass.Dr.sc. Arben Sahiti
8	Z	Kontabiliteti i Institucioneve Financiare	2	2	6	Prof.Dr. Skender Ahmeti
9	O	Punimi i diplomës			6	
Total (30 ECTS x 25 orë = 750)					30	

Shkurtesat: O – Obligative; Z – Zgjedhore; L – Ligjerata; U–Ushtrime; ECTS – kredit

Udhëzim: Tek lëndët zgjedhore për vitin e tretë, semestri i VI-të, nga moduli përkatës studenti zgjedh dy nga lëndët zgjedhore.

2.5 Studentët

Vend të posaçëm në strukturat organizative i është kushtuar pjesëmarrjes së studentëve.

Përfaqësimi i studentëve theksohet me: Në bazë të statutit të Universitetit, dy përfaqësues të studentëve janë anëtarë me të drejtë vote të Organit më të lartë të Universitetit – Senatit; në Këshillin Drejtues është një anëtar-student vëzhgues; në Komisionin për studime dy studentë marrin pjesë me të drejtë vote; në Këshillat e Fakulteteve marrin pjesë me të drejtë vote përfaqësuesit e studentëve.

Për organizimin e aktiviteteve të studentëve, menaxhmenti i UKZ-së ka siguruar përkrahje të plotë, duke siguruar hapësirë të nevojshme dhe logjistikë tjetër të nevojshme. Në bazë të buxhetit të UKZ ndahen bursa për studentët për çdo vit.

Administrata e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan ka për qëllim që të jetë në shërbim të studentëve dhe të përpunojë dhe arkivojë me kujdes secilin dokument i cili gjenerohet nga Institucioni apo është pjesë e dokumentacionit të dosjes së studentit apo të punonjësit të Institucionit. Kështu, Administrata përveç që është përgjegjëse për dokumentacionin e stafit menaxhues të UKZ-së, për dokumentacionin e mësimdhënësve të rregullt dhe të angazhuar të UKZ-së, të dokumentacionit të punonjësve tjerë të Institucionit; kujdeset edhe për:

- Dokumentacionin e kandidatëve që paraqiten për regjistrim në UKZ,
- Dokumentacionin e studentëve të UKZ

- *Mbarvajtjen e provimeve dhe dokumentacionit të nevojshëm për provime të studentëve,*
- *Mbarvajtjen dhe informimin me orarin e ligjëratave,*
- *Bibliotekën e Universitetit dhe pasurimin e saj,*
- *Mirmbajtjen e shërbimeve të internetit etj.*
- *Punët e tjera që kanë të bëjnë me jetën studentore.*

Pjesë e posaçme e punës së stafit akademik është orari i konsultimeve me studentë. Çdo mësimdhënës është i obliguar të shpall orarin e konsultimeve me studentë, së paku një herë në javë.

Bazuar në misionin e UKZ-së, preokupim kryesor i UKZ-së është përgatitja e studentëve për karrierë të suksesshme. Pjesë e procesit mësimor në të gjitha fakultetet është mësimi praktik, për këtë arsye, UKZ ka lidhë marrëveshje me institucionet përkatëse për zhvillimin e mësimi praktik. kështu, studentët e FE, do të realizojnë mësimin praktik në institucionet publike dhe bizneset. Në këtë mënyrë, do të krijojmë të gjitha parakushtet që studentët tanë të kenë karrierë të sukseshme pas përfundimit të studimeve në UKZ.

Në këtë mënyrë, do të krijojmë të gjitha parakushtet që studentët tanë të kenë karrierë të sukseshme pas përfundimit të studimeve në UKZ.

Ngarkesen e studentëve

Në këtë mënyrë, duke llogaritur se gjatë javës studenti angazhohet 40 orë, viti akademik i ka 37 javë mësimore (15+15+2+2+3), fitojmë angazhimin gjatë vitit akademik. Angazhimi i studentit gjatë një viti=1500 orë.

Andaj, studenti gjatë një viti akademik do të akumulojë 60 kredi në mënyrë që ta përfundoj vitin akademik me sukses, kështu kemi:

- Duke llogaritur që numri i përgjithshëm i orëve në semestër duhet të jetë 750, përfshirë këtu edhe ligjeratat, ushtrimet, punën praktike, seminarat, punën individuale (bibliotekë dhe shtëpi) si dhe provimet apo aktivitetet tjera vlerësuese, në të gjitha lëndët që e formojnë strukturën e programit mësimor për semestër dhe pastaj përcaktohen individualisht kreditë për secilën lëndë veç e veç, duke u kujdesur gjithnjë që të mos kalohet 750 orë apo 30 kredi të përgjithshme në semestër.

Në rastet kur paraqitet numër jo i plotë i kredive është lejuar rrumbullaksimi, psh kur një lëndë ka 135 orë, atëherë ajo ka 5 kredi, (në raste të caktuara mund të jenë edhe 6 kredi), ndërsa lënda e cila ka 105 orë, do të ketë 4 kredi. Programi i studimeve është 3 vite (dmth. 180 ECTS). Ngarkesa e studentit për tri vite përfshinënë total 4500 orë mësimore për 6 semestra (1 semestër ka 30 ECTS / 750 orë).

Standardi 5.1.

Ekziston një procedurë e pranuar zyrtarisht në nivel institucional që programi i studimit përkrahë rekrutimin e studentëve. Kërkesat për pranim aplikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtë për të gjithë studentët.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Kërkesat për pranim aplikohen në mënyrë të vazhdueshme për të gjithë studentët me rastin e regjistrimit. Kriteret të cilat duhet përmbushur janë në harmoni të plotë me Udhëzimet e MASH-it. Po ashtu me rastin e rekrutimit të studentëve të rinj, respektohet edhe rregullat për kualifikimet e huaja në prajtim me Konventën e Lisbonës.

Standardi 5.2.

Të gjithë studentët e regjistruar në programin e studimeve posedojnë një diplomë të diplomës së shkollës së mesme ose një dokument tjetër ekuivalent studimi, sipas kërkesave të MASH-it.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Studentët e regjistruar në programin e studimeve bachelor paraprakishtë duhet të posedojnë një diplomë të shkollës së mesme dhe certifikatën e kryerjes së testit të maturës.

Standardi 5.3.

Grupet e studimit janë dimensionuar në mënyrë që të sigurojnë një proces efektiv dhe interaktiv të mësimdhënies dhe mësimit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Grupet e ligjëratarave dhe ushtrimeve janë të përcaktuara sipas rregulloreve në fuqi të UKZ, përkatësisht sipas vendimit të Senatit. Krahas kësaj, edhe brenda përbrenda ligjëratarave organizohet punë në grupe, sidomos gjatë ushtrimeve krijohen grupe të vogla me 2-3 studente të cilët trajtojnë probleme të ndryshme, varësisht nga specifikat e lëndës. Gjithashtu këto grupe funksionojnë/bashkëpunojnë në kryerjen e detyrave po projekteve që ju jepen si detyrë shtëpiaje.

Standardi 5.4.

Reagimi ndaj studentëve mbi performancën e tyre dhe rezultatet e vlerësimeve jepet menjëherë dhe shoqërohet me mekanizma për ndihmë nëse është e nevojshme.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Performanca e studentëve është çështje e cila në vazhdimësi monitorohet dhe vlerësohet nga ana e profesorit dhe asistentit, pra kryesisht ka një qasje të vlerësimit formativ. Studentët informohen me kohë lidhur me vlerësimin e aktivitetit të tyre. Në raste kur studentët kanë vështësi për të arritur rezultatet e kërkuara, organizohet mësim shtesë nga asistentët, organizohen konsultime nga ana e profesorëve. Pra studentët i kanë të gjitha mundësitë që të shfrytëzojnë ndihmën e stafit edhe jashtë orarit të rregullt për të tejkaluar vështirësitë eventuale në mësimnxënie.

Standardi 5.5.

Rezultatet e fituara nga studentët gjatë gjithë cikleve të studimit janë të certifikuara nga të dhënat akademike.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Në UKZ aplikohet Sistemi i Menaxhimit Universiter (SMU) ku evidentohet cdo rezultat i studentëve dhe pastaj në cdo kohë mund të raportohen përmes certifikatës së notave, si dokument zyrtar. Në mbarim të studimeve Universiteti prodhon dokumente si certifikata e notave diploma dhe suplementi i saj të cilat prezantojnë rezultatin e studentit.

Standardi 5.6.

Trajtimi fleksibël i studentëve në situata të veçanta është siguruar në lidhje me afatet dhe kërkesat formale në program dhe në të gjitha provimet.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Trajtimi fleksibil në Fakultetin Ekonomik konsiston në faktin se profesorët dhe asistentë shprehin gatishmëri që tu dalin në ndihmë studentëve sa herë që ata kanë nevojë. Kështu ndodhë edhe në afate të provimeve. Pra, në mes profesorit dhe studentit ekziston një raport interaktiv që nënkupton një bashkëpunim permanent në trajtimin e nevojave dhe kërkesave të studentit. Po ashtu trajtim fleksibil konsiston në faktin se studentët edhe pas nënshtrimit të provimit final me shkrim, mund të përmiorësojnë rezultatin e tyre gjatë kohës së konsultimeve që organizohen nga cdo profesor pas publikimit të rezultatit të provimit final.

Standardi 5.7.

Regjistrimet e niveleve të përfundimit të studentëve mbahen për të gjitha kurset dhe për programin në tërësi dhe përfshihen në mesin e treguesve të cilësisë.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Çdo mësimdhënës, pasi të mbaj provimin vendos notat në SMU dhe prodhon dokumente të tilla si: fletëparaqitja fizike, lista e notave dhe statistika e kalueshmërisë. Fletëparaqitja fizike vendoset në dosjen e studentit kurse dy dokumentet tjera në arkivën e fakultetit.

Me mbarimin e të gjitha kurseve krijohet mundësia edhe e mbrojtës së temës së diplomës e cila gjithashtu ka procedurat e veta të caktuara me [rregulloren](#) përkatëse.

Standardi 5.8.

Procedurat efektive po përdoren për të siguruar që puna e paraqitur nga studentët është origjinale.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Diplomimi për shkallën BACHELOR arrihet me mbrojtjen e diplomës përmes procedurave të parapara nga rregullorja për studime bachelor FE, për mbrojtjen e temës së diplomës të FE, njihërit duke siguruar që puna e paraqitur nga studentët është origjinale.

Standardi 5.9.

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve bëhen publike, i promovohen të gjithë atyre që janë të interesuar dhe zbatohen në mënyrë të barabartë; këto do të përfshijnë të drejtën për apelimet akademike.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve janë të përcaktuara me Statutin e Universitetit, Rregulloren e Studimeve bachelor, Rregulloren për procedurat disiplinore dhe dokumentet të tjera që janë publike dhe në dispozicion të të gjithëve. (shih shtojcat).

Standardi 5.10.

Transferimi i studentëve ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, fakulteteve dhe programeve të studimit rregullohet qartë në dokumentet e brendshme formale.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Transferimi i studentëve ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, fakulteteve dhe programeve të studimit implementohet sipas Statutit dhe rregullores për transfer përmes komisionit për njohjen e provimeve për transfer bazuar në dokumentacionin (kërkesën për transfer, certifikatën e provimeve të dhenë etj.) të kërkuara sipas konkursit.

Standardi 5.11.

Stafi akademik është i qasshëm në çdo kohë për këshilla dhe konsultime për studenta.. Ndhima adekuate e mentorit ka të bëjë me mundësinë e të kuptuarit dhe zbatimit të mësimit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Në pajtim me [rregulloren](#) mbi studimet bachelor, dokumentet të tjera relevante të institucionit si dhe në bazë të kontratës të punës, çdo pjestar i stafit akademik dhe njësisve tjera është në funksion të mbarvajtjes dhe suksesit të punës së studentit me qëllim të përfundimit të studimeve me kohe dhe të sukseshme.

Tabela 22: Analiza SWOT për studentët:

A. Pikat e forta	B. Dobësitë
<ul style="list-style-type: none">▪ Ekziston baze ligjore e mjaftueshme dhe afirmative e cila siguron te drejtat e studenteve dhe detyrimet e tyre▪ Ekziston përfshirje e garantuar e studenteve ne strukturat vendimmarrëse▪ Studentet janë te organizuar ne organizata studentore përmes te cilave përfaqësohen ne strukturat e Fakultetit dhe Univeristetit.▪ Ekziston hapësire e konsiderueshme ligjore dhe qasje pozitive menaxheriale qe studenteve tu krijohet kushtet per përfshirje substanciale ne jetën universitare.	<ul style="list-style-type: none">▪ Vullneti jo i duhur per përfshirje ne aktivitete jashtë studimore▪ Neglizhimi i vijimit te ligjëratave dhe ushtrime▪ Mungesa e inisiativave per organizim te aktiviteteve krijuese

C. Mundesite	D. Sfidat
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Perfitimi i njohurive teorike dhe praktike përmes kurseve shtese brenda fakultetit. ▪ Angazhimet në projektet hulumtuese ne kuader te zyres se Fakultetit dhe parlamentit studentor ▪ Mundesi per realizimine e punës praktike ne biznese përmes Bordit Industrial ▪ Mundesi per realizimine e punës praktike ne institucione shteterore ▪ Mundësit e aplikimit për vazhdim të studimeve jashtë vendit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shfrytezimi i te arriturave ne fushën e teknologjisë ▪ Shfrytezimi i paktë i literatures se re ne fushat specifike nderkombetare ▪ Cilësia e studentëve të rinj ▪ Emigrimi i të rinjve

2.6 Hulumtimi

Universiteti ka [Plan Strategjik 2017-2022](#), të cilën e ka rishikuar në vitin 2020 dhe e cila përmban një kapitull të veçantë për Objektivat Strategjike. Në kuadër të këtyre objektivave hynë edhe Objektiva numër 6, e cila përfshinë përmirësimin dhe promovimin / përkrahjen e punës kërkimore shkencore në UKZ. Kjo strategji dhe objektivat e saj përfshijnë elemente si në vijim, e të cilat direkt do të ndikojnë në rritjen e hulumtimit shkencor në UKZ.

Nënobjektiva e parë thekson se UKZ duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë punës kërkimore dhe shkencore dhe sidomos të orientuar në të mirë të komunitetit. UKZ mbështetë botimin e veprave shkencore dhe të teksteve universitare, publikimin në revistat shkencore dhe nxitë punën kërkimore-shkencore të stafit akademik, duke ofruar mbështetje, si në aspektin teknik ashtu edhe në atë financiar. Në këtë aspekt është miratuar edhe [Rregulloren](#) për veprimtarinë kërkimore – shkencore, ku me anë të saj, do të përkrahet stafi akademik ne hulumtime shkencore dhe publikime shkencore.

Senati i UKZ-së, nw mbledhjen e XX dt.11.01.2020, ka miratuar Strategjinë për Hulumtime Shkencore. Strategjia përkufizon se çfarë nënkuptohet me veprimtari kërkimore shkencore në UKZ. Strategjia ka listuar objektivat në hulumtimin shkencor. Ajo parasheh formimin e Qendrës hulumtuese që do të koordinojë aktivitetin hulumtues kërkimor. Ky dokument parasheh themelimin e revistave shkencore, publikimin e teksteve universitare, organizimin e konferencave shkencore, publikimet në revista ndërkombëtare, etj.. Strategjia parasheh se secili staf akademik të publikojë së paku një publikim shkencor brenda një viti.

Standardi 6.1.

Programi i studimit ka përcaktuar objektivat kërkimore shkencore / të aplikuara (vetë ose si pjesë e një qendre kërkimore ose programi ndërdisiplinor), të cilat reflektohen edhe në planin e zhvillimit të kërkimit të institucionit; burimet e mjaftueshme financiare, logjistike dhe njerëzore janë alokuar për arritjen e objektivave të propozuara të hulumtimit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Plani hulumtues është në përputhje me strategjinë hulumtuese në nivel universiteti. Gjitashtu, UKZ ka hartuar [Rregulloren](#) për veprimtarinë kërkimore shkencore e cila përpos që përcakton prioritetet dhe orientimet kërkimore përmban edhe pjesë e mbështetjes financiare të projekteve shkencore.

Më miratimin e Rregullores për për Veprimtari Kërkimore-Shkencore të UKZ kostoja buxhetore për hulumtime shkencore është rritur: përveç pagesës për publikime në revista ndërkombëtare me impakt faktor dhe shpërblimi financiar “hulumtuesi i vitit”, rregullorja parasheh një përqindje të financave që merr autori-autorët e secilit projekt hulumtues që konkurron në fondet kombëtare për hulumtim.

UKZ ka krijuar edhe Komisionin për hulumtime shkencore konform [Rregullores për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore e UKZ-së](#). Rektori i UKZ, me [Vendimin numër 01/1857](#) të datës 30.09.2019 ka formuar Komisionin për vlerësimin për financim nga UKZ të punimeve të stafit akademik në revista, konferenca shkencore, simpoziume dhe kongrese shkencore ndërkombëtare.

Hulumtimi shkencor në UKZ është orientuar në realizimin e objektivave strategjike dhe të atyre specifike në Planin Strategjik.

Në këtë kaudër FE ka përcaktuar objektivat e hulumtimeve shkencore të cilat janë të ndërlidhura me këtë rregullore dhe me planin e zhvillimit të hulumtimeve dhe në harmoni me objektivat e vendosura nga MASH.

UKZ-i, në përgjithësi si Universitetin e ri si dhe FE në veçanti është në fazën e zgjerimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar me partner të ri dhe ekzistues, të cilat në fokus kanë studentin, mobilitetin e stafit si dhe hulumtimin shkencor. Si pjesë e angazhimit për forcimin e komponentës kërkim shkencor është edhe projekti ReserchCult ku UKZ është koordinator i projektit dhe ku janë përfshirë një pjesë e stafit të Fakultetit Ekonomik.

Standardi 6.2.

Pritjet për përfshirjen e stafit mësimdhënës në veprimtaritë kërkimore dhe akademike janë specifikuar qartë dhe performanca është përcaktuar në kriteret e vlerësimit dhe promovimit të stafit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Kriteret bazë për promovimin dhe avancimin e stafit mësimdhënës në lidhje me përfshirjen e personelit mësimor në veprimtaritë kërkimore dhe akademike përcaktohen nga UKZ dhe janë në përputhje me rregulloret e MASH.

Bazuar në statutin e UKZ dhe rregulloren e promovimit është përcaktuar qartë se sa publikime duhet të ketë të publikuara secili mësimdhënës, që të promovohet në gradë akademike.

Organizimi i konferencave shkencore, simpoziume, tryeza të rumbullakëta, punëtorive bëhet në bashkëpunim me nivelin e lartë të menaxhmentit të UKZ-it.

Fakulteti Ekonomik, së shpejti do të organizon konferencë shkencore me karakter ndërkombëtar, ku pjesëmarrës do të jenë stafi mësimdhënës, hulumtuesit, studentët, alumnit dhe bizneset. Publikimet e dalura nga këto konferenca shkencore do të procedohen me ISBN, në raportet shkencore të ISSN-së ose në revista të dedikuara për atë aktivitet të caktuar shkencor.

Standardi 6.3.

Janë krijuar politika të qarta për përcaktimin e asaj që njihet si hulumtim, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe normat e vendosura në fushën e studimit të programit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Përmes Statutit të UKZ dhe Rregulloreve për zgjedhjen dhe avancimin e stafit akademik janë të përcaktuara qartë se cka konsiderohet punë hulumtuese dhe e cila është kusht për pranimin në punë por edhe për avancimin në grada akademike të stafit aktual. Këto standarde jithashtu janë në harmoni me Ligjin mbi arsimin e lartë në Kosovës dhe Udhëzimet administrative përkatëse. UKZ ka themeluar edhe Këshillin Botues dhe ka miratuar [Rregullore](#) për punën e Këshillit Botues, ku përcaktohen qartë kriteret e punës hulumtuese shkencore.

Standardi 6.4.

Stafi akademik ka një histori të provuar të rezultateve të hulumtimit në të njëjtat tema si aktiviteti i tyre mësimor.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Stafi akademik kryen kryesisht kërkime individuale, dhe disa prej tyre bëjnë kërkime aplikative me ndikim në komunitet, te cilat gjithashtu lidhen me aktivitetin e tyre mësimor. Personeli aktual i këtij programi është përbërë prej gjashtë doktorve të shkencës nga fusha e ekonomisë, të cilët kanë botuar një numër të konsiderueshëm librash, artikuj shkencorë, gjetje kërkimore që lidhen me aktivitetet e tyre mësimore dhe hulumtimet shkencore. Këto rezultate janë prezantuar edhe në konferenca të shumta në Kosovë dhe jashtë saj. Lista e hulumtimit të stafit akademik FE është i bashkangjitur në këtë RVV. FE ka prezentuar strategji për identifikimin dhe kapitalizimin e ekspertizës së stafit mësimdhënës dhe studentëve në ofrimin e shërbimeve kërkimore dhe zhvillimore me fokus në komunitetin. Në këtë mënyrë poqese rezultatet hulumtuese kanë output një produkt / shërbim atëherë tentohet që nga ai produkt/shërbim të përfitojë komuniteti si për kah ngritja e kualitetit, efienca dhe kostoja e gjithashtu duke i kushtuar rëndësi të veçantë ruajtjes së ambientit.

Standardi 6.5.

Stafi akademik dhe hulumtues publikojnë punën e tyre në revista specialiteti ose shtëpi botuese, produktet shkencore/aplikative/artistike prezantohen në konferenca, seanca, simpoziume, seminare etj. Kontratat, ekspertiza, konsultimet, konventat etj. U ofrohen partnerëve brenda vendit dhe/ose jashtë vendit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Stafi akademik dhe hulumtues kanë botuar dhe janë ende në proces të publikimit të një numri të konsiderueshëm të librave në shtëpitë botuese, artikuj shkencorë janë botuar në revista speciale me indekse në platformat e rekomanduara nga MASH dhe UKZ.

Këto botime paraqiten në konferenca, seminare, simpoziume në Kosovë dhe jashtë saj. Shumica e këtyre botimeve kanë qasje të hapur dhe janë në dispozicion për të gjithë përdoruesit brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë vlerësimit të kandidatëve për promovim, kërkohet që punimet të publikohen në fushën e kandidatit, në revista të cilat indeksohen në platformat përkatëse akademike, dhe kategorizohen si më poshtë:

1. Platforma dhe revista – indeksimi në bazën e të dhënave të revistave shkencore të vlerësuara në mënyrë të barabartë me koeficientin prej 1 (100%) janë:

- 1.1 Web of Science
- 1.2 Scopus
- 1.3 Ebsco,
- 1.4 Worldcat
- 1.5 DOAJ

2. Senati zgjodhi 3 platforma. Platformat e senatit janë ekuivalente me koeficientin 0.85 (85%) dhe janë:

- 2.1 WorldWideScience
- 2.2 Microsoft Academic Search
- 2.3 BASE (Bielefeld Academic Search Engine)

Fakulteti Ekonomik monitoron nga afër kontributin e të gjithë stafit për tërheqjen e burimeve financiare përmes projekteve kërkimore / aplikative / artistike / produktit dhe produkteve. Institucioni është shumë mbështetës dhe përpiqet të krijojë kushte për stafin që kanë ide për dizajnimin e projekteve kërkimore që ofrojnë fonde për projekte kërkimore, veçanërisht pasi burimet financiare janë të kufizuara. Kapacitetet e personelit për të gjeneruar fonde kërkimi si dhe përfitime financiare nga projektet e hulumtimit konsiderohen në një rishikim individual të performancës.

Standardi 6.6.

Hulumtimi vërtetohet nëpërmjet: botimeve kërkimore shkencore dhe aplikative, produkteve artistike, transferimit teknologjik përmes qendrave të konsulencës, parqeve shkencore dhe strukturave të tjera për validim.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

FE përmes stafit akademik është prezent në shumë revista dhe institucione arsimore në nivel ndërkombëtar. Ka një kualitet solid të kërkimit shkencor komponentë kjo që duhet të avancohet edhe më shumë. Gjithashtu stafi dhe studentët angazhohen edhe në aspektin e konsulencës përmes hulumtimeve të ndryshme që bëjnë për organzzata të ndryshme biznesore dhe jobiznesore.

Standardi 6.7.

Çdo anëtar i stafit akademik dhe studiues ka prodhuar së paku një punim kërkimor shkencor në vit për tre vitet e fundit.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Çdo anëtar i stafit akademik dhe hulumtues ka publikuar së paku një punim i cili ka karakter kërkimor shkencor në tre vitet e fundit ([shih listën e publikimeve stafit akademik në shtojcë](#)).

Standardi 6.8.

Stafi akademik dhe hulumtues publikon nën emrin e institucionit në Kosovë, ku ata janë të punësuar si staf me kohë të plotë.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Stafi akademik përmes hulumtimit të punës shkencore të tyre, publikimet i realizojnë në emër të institucionit ku janë të punësuar apo në bashkëpunim me hulumtuesit nga institucionet të tjera. Për këtë arsye krahas mundësive financiare UKZ përkrahë stafin akademik në publikime në revista prestigjioze konform rregullores UKZ dhe rregullores së MASH.

Standardi 6.9.

Janë kriuar politika mbi pronën intelektuale andaj dhe procedurat janë të qarta për materializimin e ideve të zhvilluara nga stafi dhe studentët.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Përmes politikave mbi pronësinë intelektuale në UKZ janë definuar kriterët kur puna kërkimore shkencore është vepër autoriale dhe si e tillë është e mbrojtur. Nderkohe pritet që në këtë drejtim të ketë edhe më tutje avancim për stimulimin dhe përkrahjen e ideve të reja.

Standardi 6.10.

Studentët janë të angazhuar në projekte kërkimore dhe aktivitete të tjera.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Studentët përmes punës hulumtuese, janë të angazhuar në projekte kërkimore, qoftë për arritje të rezultateve gjatë studimit apo me qëllim të botimit në revista shkencore. Megjithëkëtë, ky ende është një nivel i ulët i pjesëmarrjes në këto aktivitete për sa i takon nivelit bachelor. Në të ardhmen, kjo komponentë do të trajtohet me shumë përparësi nga menaxhmenti i FE dhe UKZ.

Tabela 23: Analiza SWOT për hulumtim:

A. Pikat e forta	B. Dobësitë
<ul style="list-style-type: none">• Stafi i kualifikuar, i motivuar dhe me përvojë në fushën e hulumtimit (kanë publikuar një numër të konsideruar librash, artikuj shkencorë si dhe kanë marrë pjesë në konferenca të shumta brenda dhe jashtë vendit).• Marrëveshjet me bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare;	<ul style="list-style-type: none">• Mungesa e qasjes në databaza ndërkombëtare;• Mungesa e softuerit aplikativ për plagjiarizëm.• Problemet financiare në përcjelljen e konferencave dhe kuotizimi për botime.

<ul style="list-style-type: none"> • Trajnimi i stafit për hulumtime shkencore (projekti EUFORIA) etj. • Koncentrim i të gjitha fakulteveve brenda një kampusi mundësi për bashkëpunim ndërdisiplinor. 	<ul style="list-style-type: none"> • Pamjaftueshmëria e njohjes së gjuhëve të huaja.
C. Mundësit	D. Sfidat
<ul style="list-style-type: none"> • Aplikim për financimin e projekteve unike dhe bashkëpunimit me partnerë përmes Erasmus + dhe Horizon 2020. • Përkrahje financiare nga MASH-i për projekte hulumtuese, pjesëmarrje në konferenca, punëtori, simpoziume vendore dhe ndërkombëtare. • Themelimi i një instituti në kuadër të universitetit për kërkime dhe analiza ekonomike. • Pasurimi i bibliotekës 	<ul style="list-style-type: none"> • Procedura të komplikuar dhe të stërzgjatura që vështirësojnë udhëtimet ndërkombëtare me qëllim bashkëpunimit me projekteve dhe punë hulumtuese (aplikimi për viza etj).

2.7 Infrastruktura dhe burimet

Standardi 7.1.

Zbatimi adekuat afatgjatë i programit studimor sigurohet në tregues sasiorë për sa i përket ambienteve, burimeve njerëzore dhe pajisjeve. Në të njëjtën kohë, garantohet që aspektet cilësore të merren parasysh gjithashtu.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

UKZ ka hapësira të mjaftueshme, salla mësimore, salla leximi, kabinete dhe hapësirë solide edhe për stafin akademik për zbatimin adekuat afatgjatë të programit studimor “Financë dhe Kontabilitet i aplikuar”. FE garanton studimet cilësore të mësimdhënjes dhe mësimnxënjes në programin studimor bachelor Financë dhe Kontabilitet i aplikuar, duke pasur parasysh edhe hapësirat e mjaftueshme për studim.

UKZ ka startuar me përdorimin e Sistemit të Menaxhimit Universitar (SMU), softuer për menaxhimin e të dhënave universitare, në veçanti të atyre të studentëve, duke përfshirë nga konkurrimi për pranimi deri në diplomimin e tij. Të dhënat e studentëve ruhen pa limit.

UKZ ka instaluar edhe përdorimin e e-learning-ut. Studentët dhe stafi akademik e përdorin në procesin akademik të mësimin, konsultimeve, detyrave të shtëpisë dhe në komunikime të tjera akademike.

Standardi 7.2.

Ekziston një plan financiar në nivelin e programit të studimit që do të demonstroi qëndrueshmërinë e programit të studimit minimalisht për tre vitet e ardhshme.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

UKZ është universitet publik dhe financohet nga Buxheti i Kosovës. MASH cakton tarifat e shkollimit. UKZ harton Buxhetin e vet në konsultim me MASH (në periudhën e përkohshme) dhe Ministrinë e Financave, dhe i njëjti miratohet në kuadër të Ligjit të Buxhetit të Kosovës.

Plani i financimit te njësise FE dhe programit studimor aktual është pjesë e planit të financimit të UKZ.

Ne web gjeni detajet e [planit financiar të UKZ-së](#), kurse nw tabelat nw vijim gjeni buxhetin e lejuar nga MASH për 3 vitet në vijim.

Tabela 24: Plani financiar 2021-2023

Buxheti 2021	Buxheti-Projeksion 2022	Buxheti-Projeksion 2023	Totali 4 (3+2+1)
2,547,642.99€	2,995,640.99€	3,045,421.00€	8,588,704.98€

Tabela 25: Kategorit e shpenzimeve

Kategoria ekonomike	Buxheti 2021	Buxheti-Proj. 2022	Buxheti-Proj. 2023	Totali 4 (3+2+1)
Planifikimi i shpenzimeve 2021 – 2023				
Paga dhe mëditje	1,297,642.99€	1,297.642.99€	1,347,423.00€	3,942,708.98€
Mallra dhe shërbime	400,000.00€	347,998.00€	347,998.00€	1,095,996.00€
Shpenzime komunale	50,000.00€	50,000.00€	50,000.00€	150,000.00€
Subvencione dhe transfer	100,000.00€	100,000.00€	100,000.00€	300.000.00€
Pasuritë Jofinanciare	700,000.00€	1,200,000.00€	1,200,000.00€	3,100,000.00€
Totali	2,547,642.99€	2,995,640.99€	3,045,421.00€	8,588,704.98€

Standardi 7.3.

Institucioni i arsimit të lartë duhet të demonstrojë me dokumente adekuate (veprat e pronës, kontratat e qirasë, inventarët, faturat etj.) që, për programin e studimit të dorëzuar për vlerësim, ka të paktën tre vitet e ardhshme:

a) hapësira në pronësi ose me qira të përshtatshme për procesin arsimor;

b) laboratorë në pronësi ose me qira, me pajisje adekuate për të gjitha disiplinat e detyrueshme brenda kurrikulit, kudo që programi mësimor analitik përfshin aktivitete të tilla; softuer adekuat për disiplinat e studimit të përfshira në kurrikulë, me licencë përdorimi;

d) biblioteka e pajisur me sallat e leximit, dhomat e punës në grup dhe rezervat e veta të librave sipas disiplinave të përfshira në kurrikulat.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

UKZ funksionon në kuadër të një kampusi ku janë të koncentruara të gjitha fakultetet.

Hapësira është në pronësi të Universitetit dhe nuk ka objekte me qira. Universiteti posedon bibliotekën e përbashkët për të gjitha fakultetet. Fakultetit Ekonomik ka ne dispozicion kabinetin e TI te pajisur me kompjuter dhe programe softuerike sipas kërkesave te mësimdhënësve për lendet përkatëse.

Standardi 7.4.

Numri i ulësve në sallat e ligjëratave, dhomat e seminarit dhe laboratorët duhet të lidhet me madhësinë e grupeve të studimit (seri, grupe, nëngrupe); aktivitetet aplikative për disiplinat e specializuara të përfshira në kurrikula janë kryer në laboratorë të pajisur me pajisje të IT.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Sa i përket numërit të ulësve në sallat ku mbahen ligjëratat, seminarët, etj, janë të mjaftueshme për grupet dhe nëngrupet e studenteve sipas specializimeve duke përfshirë kurrikulat sipas plan programit mësimorë. FE, është i pajisur me pajisje solide për mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimve. Në tabelën në vijim janë të paraqitur të dhënat sa i përketë infrastrukturës përkatsisht hapsirës së FE që e posedon nënshfrytëzim.

Universiteti ka një sipërfaqe e cila i plotëson nevojat e programeve studimore. Kampusi ekzistues përbëhet prej dy objekteve të mëdha, të ndërlidhura midis tyre dhe të përshtatshme për aktivitete mësimore. Gjendet në një pozitë të përshtatshme, brenda qytetit, me një mundësi të përshtatshme për qasje nga studentët dhe stafi. Objekti kryesor ka një hapësirë prej 6500 m², për zyrat e stafit akademik dhe administrativ, sallat e mësimi, laboratorët, kabinetet, bibliotekën dhe infrastrukturën tjetër të paraqitur në tabelën 1 dhe 2, ndërsa komplet Kampusi i UKZ-së në total ka një hapësirë prej 2ha ose 20000 m². UKZ, bashkë me Komunën e Gjilanit dhe me Qeverinë e Kosovës është duke planifikuar zgjerimin e kampusit aktual edhe me një objekt të madh apo ndërtimin edhe të një kampusi të ri në tjetër pozicion (7,3 ha).

Struktura e hapësirave duke përfshirë zyrat e administratës, sallave të mësimi, laboratorëve, kabineteve, bibliotekës etj., paraqitet me anë të tabelës në vijim.

Tabela 26: Paraqitja e të dhënave për: hapësirat, sallat e mësimi, kabinetet, amfiteatrot sipas numrit dhe sipërfaqës në m² që shfrytëzohen FE

Zyret	Nr. i zyreve	Hyrja A	Hyrja B
Zyra e Këshillit Drejtues	1	Kati I	
Zyret e Menaxhmentit	5	Kati I - Rektorat	
Zyret e Dekanëve	5	Kati I, II	Kati P,I,II
Zyret e stafit Akademik	19	Kati I, II,III	Kati P, I, II
Zyret e stafit Administrativ	19	Kati P, I, II	Kati P, I,
Zyrja e Parlamentit Studentor	1		Kati II
Depo	3	Kati nëntoksor, P	

Hapësirat e UKZ-së për organizimin e procesit mësimor janë për 907 studentë në hyrjen A dhe 555 në hyrjen B, apo gjithsej për 1462 studentë në të njëjtën kohë. Ky numër sipas nevojës mund të rritet deri në 1735 studentë.

Struktura e hapësirave për ligjëratat është e shpërndarë në dy hyrjet e objektit të UKZ-së: A dhe B. Kjo shpërndarje është si në vijim

Hyrja A		Hyrja B	
Salla nr.	Nr. i ulëseve	Salla nr.	Nr. i ulëseve
A01	60-80	Amfiteatër i vogël (B01)	50-70
A02	60-80	B02	80-90
A12	58-65	B03	25-35
Klasa e dedikuar për parashkollor (A14)	50-70	Salla e Informatikës / Laborator i rrjeteve kompjuterike(B10)	30
A21	40-45	B11	100-110
A22	58-65	Salla e Informatikës (B12)	30
A23	40-45	B21	100-120
A25	46-50	B22	40-50
A33	46-50	B23	40-50
Laboratori i Shkencave Natyrore (A13)	24	Salla e Informatikës / Laborator i rrjeteve kompjuterike(B24)	30
Salla e Arteve (A26)	40-50	Salla e Informatikës B31	30
Kabineti i Muzikës (A24)	40-50	Total	555- 645
Salla e Konferencave (A/34)	60-70		
Salla e Leximit	250-300		
Salla mësimi	15-20		
Salla mësimi	20-30		
Total	907-1,090		

Të dhënat për pajisjet si: projektorët, mjetet e konkretizimit, aparatura laboratorike etj., relevante për institucionin dhe programin/ programet në vlerësim;

Nr. rend.	Pajisjet	Njësia
1	Kompjuterë në laboratore të Informatikës	110
2	Kompjuter për stafin akademik	70
3	Kompjuterë për administratë	38
4	Laptop	52
5	Laptop për student në laborator	15
6	Projektorë	45
7	Fotokopje	14
8	Printer	70
9	Printer për ID-kartela	1
10	Lexues Optik	1
11	WI-FI (modem)	15

12	Server	2
13	Pajisje laboratorike	15
14	Grafoskop	13
15	Kamerat e sigurië	38
16	Aparat Profesional Fotografik	4
17	Tabela Elektronike (E menqur)	4
18	Router	6
19	Switc te menaxhueshem	10
20	Switch të thjesht	15
21	UPS	50
22	Scanner	4

Regjistri fizik dhe elektronik i librave relevantë për institucionin dhe programin/ programet ne vlerësim. Fondi librar i bibliotekës gjendet ne shtojcë të RVV-së.

Standardi 7.5.

Bibliotekat e institucioneve të arsimit duhet të sigurojnë, për secilin nga programet studimore:

- a) një numër vendesh në dhomat e leximit që i përgjigjen të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të studentëve në programin e studimit;*
- b) një numër vendesh në dhomat e punës në grup që korrespondojnë me të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të studentëve në programin e studimit;*
- c) rezervat e tyre të librave nga literatura e specialiteteve Shqiptare dhe të huaja, të mjaftueshme për të mbuluar disiplinat brenda kurrikulave, nga të cilat së paku 50% duhet të përfaqësojnë tituj librash ose kurse specialiteti të publicistëve të njohur, nga 10 vitet e fundit;*
- d) Një rezervë librash në librarinë e tyre me një numër të mjaftueshëm të librave që përmbushin nevojat e të gjithë studentëve në ciklin dhe vitin e studimeve për të cilën sigurohet disiplina përkatëse ;*
- e) Një numër të mjaftueshëm të përshkrimeve për publikimet shqiptare, atyre të huaja dhe atyre periodike, sipas misionit të deklaruar.*

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Universiteti ka në dispozicion bibliotekën, e cila në fondin e saj ka literature në gjuhën shqipe, angleze, serbokroate dhe një fond më të kufizuar të literaturës në gjuhën turke dhe greke.

Fondi i përgjithshëm i librave është 52,000 ekzemplarë.

Biblioteka posedon një [fond të revistave](#). Literatura ekzistuese në bibliotekë lehtëson dhe ndihmon programet ekzistuese dhe ato në riakreditim dhe akreditim.

Përveç bibliotekës së universitetit, studentët mund të shfrytëzojnë edhe literaturën e cila gjendet në [bibliotekën e qytetit “ Fan S. Noli” në Gjiilan](#)

UKZ ka marrëveshje bashkëpunimi me [Bibliotekën Kombëtare të Kosovës](#), në bazë të së cilës UKZ ka qasje në kopjet fizike të librave të cilat gjinden në Bibliotekën Kombëtare. Po ashtu Biblioteka Kombëtare do të furnizoj bibliotekën e UKZ-së me tituj sipas mundësive.

Me qëllim të begatimit të titujve të librave në bibliotekën e UKZ-së është lidhur marrëveshje me [Rrjetin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës](#). Për këtë çështje janë shkëmbyer përvoja për qasje sa ma të lehtë në bibliotekat tjera elektronike jashtë vendit.

UKZ është pjesë e projektit Erasmus+ “ResearchCult” me anë të cilit do të krijohet qasje në një bibliotekë ndërkombëtare;

UKZ gjithashtu ndanë për cdo vit edhe fonde për blerjen e librave;

UKZ furnizohet me libra edhe nëpërmjet projekteve Erasmus+, si me SMAHPC, ENEMLOS, etj.

Standardi 7.6.

Infrastruktura dhe objektet e dedikuara për zbatimin e programit përshtaten me student me nevoja të veçanta.

Përputhshmëria e Fakultetit Ekonomik

Infrastruktura dhe objektet e dedikuara për zbatimin e programit pjesërisht përmushë kërkesat e studentëve me nevoja të veçanta.

Tabela 27: Analiza SWOT për infrastrukturë dhe burime:

A. Pikat e forta	B. Dobësitë
<ol style="list-style-type: none"> 1. Ekziston një plan financiar në nivelin e UKZ që demonstroi qëndrueshmërinë e programit Financë dhe Kontabilitet i aplikuar 2. Përdorimi i SMU 3. Përdorimi i e-learning 4. Sallat e mësimit plotësojnë kushtet mesatare për mbajtjen e mësimit. 5. Sallat janë të pajisur me mjete të konkretizimit, projektor, tabela dhe internet 6. Fakulteti ka në dispozicion kabinetin e TI 7. Shfrytëzimi i Bibliotekës në kuadër të UKZ-it, ku ka një hapësirë të mjaftueshme edhe për studentët e FE. 8. Furnizimi vjetor me literaturë të re. 9. Në të gjithë hapësirat e UKZ ka shërbim të internetit i cili do të shërbejë si burim i literaturës së nevojshme 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Hapësirat për mbajtjen e mësimit të vjetruara. 2. Buxheti i pamjaftueshëm për blerjen e pajisjeve për kabinetet e profesorëve 3. Mungesa e bibliotekës digjitale 4. Niveli i ulët i gjuhës angleze si mjet për shfrytëzim kualitativ të burimeve të informacionit.
C. Mundësit	D. Sfidat
<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbështetja financiare nga instancat më të larta institucionale 2. Ofrimi i fondit të librave nga donatorë 3. Sigurimi i librave përmes prokurimit 4. Digjitalizimi i bibliotekës 5. Pajisja e sallave, amfiteatrove me pajisje moderne. 6. Shfrytëzimi i internetit si burim i literaturës së nevojshme 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndryshimet e shpejta të pajisjeve teknologjike . 2. Mos mbështetja financiare për modernizimin e pajisjeve për mbajtjen e mësimit.

3. EVOLUCIONI DHE ZHVILLIMI I KOHËVE TË FUNDIT I REGJISTRUAR QË NGA VLERËSIMI I MËPARSHËM (nëse ka)

Rekomandimi i Ekipit të Ekspertëve në Raportin e mëparshëm të Rishikimit të Jashtëm	Zgjidhja që ofruesi ka zbatuar në adresimin e rekomandimit	Komentet e tjera relevante
<ol style="list-style-type: none"> 1. Develop sector-specific and realistic learning outcomes based on evidence from labour market research and expertise of stakeholders. 2. Use learning taxonomies to improve the quality of learning outcomes 3. Based on revised and detailed learning outcomes, develop an overarching didactic concept and implement it as well as monitor it continuously as a cooperative effort involving the entire teaching staff. 4. Survey the experiences of the first cohorts of graduates in the labour market and ask employees about their experiences with graduates, too. 5. More full-time teaching staff is required, especially with regard to the plans of establishing research activities in the future. 6. The teaching staff should be strongly supported in their initiative for internal classroom visits as well as in documentation and internal transfer of good practices in teaching. 7. UKZ should actively manage the establishment of research activities at the national and international level with broad participation of the staff of the program. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Për këtë rekomandim janë zhvilluar takime me bizneset dhe alumnit ku janë marrë parasyshtë nevojat e tyre prandaj edhe origrami është orientuar më shumë në lëndë specifike që kanë të bëjnë me aplikimin në praktikë të aspekteve teorike. 2. Në përgatitjen e syllabusëve dhe hartimin e learning outcomes bazohemi në Taksonomine e Bloom-it. 3. Kjo është temë gati rregullisht diskutohet në diskutohet në Këshillin e Fakultetit për cka janë bërë përgatitur edhe udhëzime konkret për mënyrat evlerësimit të studentëve. 4. Fakultetit ka kryer hulumtime me alumni dhe ka zhvilluar takime me punëdhënësit ku ka marrë mendimet e tyre 5. Nga koha kur janë dhënë këto rekomandime fakulteti ka shtuar numrin e stafit të rregullt nga 7 profesor me grade Dr. tash jan 12 kurse numri i stafit nga 11 tash janë 14 dhe në proces konkursi është edhe një profesor. 6. Shkëmbimi i përvojave mes stafit zhvillohet vazhdimisht përmes takimeve të përbashkëta dhe diskutimeve në Këshillin e Fakultetit 7. UKZ ka avancuar në mbështetjen e stafit për pjesëmarrje në aktivitetet hulumtuese si përmes programeve të bashkëpunimit 	

<p>8. The program is highly recommended to participate in the UKZ's strategy of hiring PhD students.</p> <p>9. The program is strongly advised to improve its library stock as soon as possible.</p> <p>10. The study programme should seek collaboration with the Office for Quality Assurance to set up a scheme for developing learning outcomes which is then used for improvement of course descriptions where necessary.</p> <p>11. A PDCA cycle should be established where the review of study program is linked to academic staff development with a focus on teaching skills.</p>	<p>ndërkombëtar ashtu edhe përmes mbështetjes financiare të projekteve hulumtues dhe pjesëmrrjes në konferenca dhe aktivitete tjera shkencore.</p> <p>8. Shumica e asistentëve janë edhe PhD students ku disa tani kanë kryer këto studime dhe ndodhen në proces të avancimit në Prof.Ass.</p> <p>9. UKZ vazhdimisht bënë furnizime me literaturë shkencore dhe biblioteka e UKZ është shumë mirë e furnizuar me libra nga fusha e ekonomisë si në gjuhën shqipe ashtu edhe të huaj.</p> <p>10. Përpos bashkëpunimit të vazhdueshëm me Zyrën për Zhvillim akademik dhe Cilësi një pjesë e stafit kanë marrë pjesë edhe në ëorkshope (EUFORIA) që kanë të bëjnë me hartimin e kurrikulave dhe zhvillimin e rezultateve të të nxëniet si për programin ashtu edhe për lëndët.</p> <p>11. Ky plan studimor është rishikuar dhe hartuar edhe nga ky aspekt konform përgatitjeve të stafit akademik dhe aftësive të tyre. Profesorët që do të jenë të angazhuar në këtë program kanë dëshmuar aftësi edhe në mësimdhënie por edhe në përvojat profesionale në praktikë gjë që i bënë ata shumë të përshtatshëm për programin.</p>	
---	--	--

4. SHTOJCAT

1. Buxheti i UKZ
2. Pyetesori i vlerësimit per student.
3. Syllabuset e lëndëve (kurikulave)
4. CV- stafit akademik
5. Lista e publikimeve të stafit Akademik
6. Lista e pjesëmarjeve të stafit në trajnime për mësimëdhënie dhe mësimnxënie
7. Lista e marveshjeve të bashkpunimit FE me bizneset dhe institucionet publike
8. Formulari për llogaritjen e ngarkesës se studentit/ ECTS;
9. Dokumente tjera relevante që sqarojnë të dhënat në RVV <https://www.uni-gjilan.net/fakultetet/fakulteti-ekonomik/dokumentet-te-rendesishme/>